



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo- Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

**RAPORT MBI
ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR AVANCIMIN
E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM
DHE ASHKALI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
2022-2026 DHE
PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024
PËR VITIN 2023**

БЕЗ АЦИИ 2023

БЕЗ АЦИИ РЕПУБЛИКИ КОСОВО-КОСОВА

Prishtinë, 2024



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Prishtinë, 2024

RAPORT

ZBATIMI I STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2022 2026 SI DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2022 2024

PËR VITIN 2023

Prishtinë, Prill 2024

Përmbajtja

SHKURTESAT:.....	4
1. HYRJE	6
2. METODOLOGJIA	7
3. ARRITJET KRYESORE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI, 2022-2026 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024.....	9
4.1 Aktivitetet, të arriturat, sfidat dhe rekomandimet	14
4.1.1 ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E ARSIMIT	14
4.1.1.1 Rekomandimet për zbatimin e strategjisë në fushën e arsimit	21
4.2. ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E PUNËSIMIT DHE TË MIRËQENIES SOCIALE.....	22
4.2.1. Rekomandimet në zbatimin e strategjisë në fushën e punësimit dhe të mirëqenies sociale ...	28
4.3. ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E SHËNDETËSISË	29
4.3.1 Rekomandimet për zbatimin e strategjisë në fushën e shëndetësisë	34
4.4. ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E BANIMIT.....	34
4.4.1 Rekomandimet e zbatimit të strategjisë në fushën e banimit	39
4.5. ZBATIMI I STRATEGJISË NË LUFTIMIN E DISKRIMINIMIT	39
4.6. Grupi punues Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si mekanizëm për luftimin e diskriminimit, në kuptim të përmbushjes së objektivave të strategjisë	40
4.6.1. Platforma Kombëtare për raportimin e rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si mekanizëm i grupit teknik, me qëllim të luftimit të diskriminimit përkitazi me përmbushjen e strategjisë dhe përcaktimeve të deklaratës së Poznait.....	42
4.7. Rekomandimet për në fushën e luftimit të diskriminimit.....	44
5. AKTIVITETET E NDËRMARRA NGA ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË / ZYRA E KRYEMINISTRIT PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NDËRLIDHUR ME PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË-SHKURT-PRILL 2023	45
5.2. Organizimi i takimit sektorial më pikat e kontakteve në Ministri dhe më shoqërinë civile që punojnë dhe përkrahin komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	45
5.3. Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës.....	46

5.4. Grupi Teknik i Punës për Koordinimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare	48
5.5. Krijimi i mekanizmave në nivel komuna/Komitetet Komunal Veprues, me qëllim të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.....	49
9.4.1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komitetit Komunal të Veprimit	52
10. HAPJA E BIBLIOTEKËS NË GJUHËN ROME.....	53
11. SAMITI I BALLKANIT PERËNDIMOR KUNDËR DISKRIMINIMIT RACOR.....	53
12. AKTIVITETET TJERA QË KANË SHËNUAR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI, 2022-2026 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024, TË CILAT JANË TË LIDHURA NË MËNYRË TË DREJTPËRDREJTË DHE JO TË DREJTPËRDREJTË ME FUSHAT DHE BJEKTIVAT E STRATEGJISË	54
13. PËRFUNDIME PËRKITAZI ME ZBATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT, NË DRITËN E PËRCAKTIMEVE TË DEKLARATËS SË POZNANIT	58

SHKURTESAT:

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
APRK	Agjencioni i Punësimit të Republikës së Kosovës
ARC	Agjencioni i Regjistrimit Civil
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEB	The social development bank for Europe
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
KKV	Komiteti Komunal i Veprimit
KPSHSF	Këshilli i Prishtinës për Shërbime Sociale dhe Familjare
LMD	Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MATP	Masave Aktive të Tregut të Punës
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OSBE	Organization for Security and Co-operation in Europe
QAP	Qendra për Aftësim Profesionë në Kosovë
QAP	Qendrat për Arsim dhe Aftësim Profesional
QKMF	Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare

QKSF	Qendra Kryesore e Shëndetësisë Familjare
QPS	Qendrat për Punë Sociale
RCC	Regional Cooperation Council
SFFAKP	Skema e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme
SIMP	Sistemit elektronik Ministrisë së Punës
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve të Arsimit
SNS	Skemat e ndihmës sociale
SNS	Skemës së Ndhmës Sociale
UA	Udhëzimin Administrativ
UNDP	United Nations Development Programme
VoRAE	Voice of Roma, Ashkali and Egyptians
WBIF	Western Balkans Investment Framework
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
ZQM / ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit

1. HYRJE

Ky Raport vjetor është hartuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM ZKM) për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024 si dhe përfshin periudhën e zbatimit për vitin 2023. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit sipas mandatit të saj ka një rol të rëndësishëm në koordinimin e zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë de Planit të veprimit. Hartimi i këtij raporti është mbështetur nga projekti "Integrimi i Romëve III", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.

Raporti paraqet gjendjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare përmes vlerësimit të zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë dhe Planit të veprimit, për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe të përmirësimit të gjendjes dhe situatës arsimore, socio ekonomike, kulturore, shëndetësore të tyre.

Më 20 korrik 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 89-të të saj, miratoi Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024.

Strategjia ka si objektiv rritjen efektive të ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës; rritjen e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe uljen e varfërisë; përmirësimin e shëndetit dhe rritjen e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore; rritjen e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike; dhe parandalimin dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykimeve, stereotipeve, dhe bullizmit për komunitetin rom dhe ashkali. Ndër të tjera, strategjia dhe plani i veprimit të saj, synon të zbatoj zotimet që kanë dalë në Deklaratën e Poznan-it, me qëllim të integrimit të romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së. Strategjia dhe Plani i veprimit gjithashtu është hartuar në bazë të Kornizës BE-së për Integrimin e Romëve, janë definuar pesë fusha të veprimit të cilat adresohen në Strategji: **arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi**.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit është një çështje kyçe për të siguruar një pasqyrë për gjendjen e komuniteteve rom dhe ashkali dhe relacion me institucionet e Kosovës në pesë fushat e përcaktuara, të Strategjisë. Të gjitha institucionet qeveritare, qendrore dhe lokale, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre, obligohen të ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali për vitin 2022-2026 dhe si rrjedhojë edhe të Planit Veprimit 2022-2024. Pjesë e rëndësishme e monitorimit të zbatimit të strategjisë është edhe monitorimi i zbatimit të Planeve Lokale të Veprimit (PLV).

Buxheti është një ndër aspektet e rëndësishme të zbatimit të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024. Institucionet e Kosovës me aprovimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit janë zotuar për ndarjen e buxhetit i cili është i bazuar në përcaktimet e planit të veprimit.

Raporti vjetor 2023 për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komunitetit rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024, përmes raportimit të të dhënave nga institucionet kompetente, pasqyron gjendjen dhe mënyrën se si është zbatuar Strategjia dhe Plani i veprimit dhe se sa është arritur efekti i zbatimit të saj në avancimin e të drejtave të këtyre komuniteteve.

Raporti ka për qëllim që të vë në pah aktivitetet që janë ndërmarrë dhe vazhdojnë të ndërmerren në drejtim të realizimit të objektivave të përmbajtura në pesë fusha të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e Veprimit për vitet 2022-2024, në fushat Arsim, Punësim dhe mirëqenie sociale, shëndetësi, banim dhe në fushën e luftimit të diskriminimit. Gjithashtu qëllimi i këtij raport, përveç vlerësimit që është bërë në pesë sektorë në bazë të objektivave të Planit të veprimit, lidhet edhe me identifikimin e problemeve, sfidave në zbatimin e aktiviteteve të përfshira në Plan të veprimit.

Përmbushja e qëllimit të këtij raporti, si dhe çështjet e identifikuar në këtë raport dhe raportet e kaluara, mund të shërbejnë si udhërrëfyes për të identifikuar aspektet e rëndësishme që kanë të bëjnë me avancimin e të drejtave të komunitetit rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës. Qëllimi i këtij raporti, po ashtu jetësohet edhe nën dritën e zotimeve të Deklaratës së Poznan-it dhe synon të nxjerr në pah punën e institucioneve të Kosovës, në drejtim të përmbushjes së zotimeve që dalin nga Deklarata e Poznan-it.

Për herë të parë, raport për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024 është hartuar për vitin 2022 dhe ky është raporti i dytë lidhur me këtë Strategji dhe plan të veprimit. Për të qartësuar qëllimin e raportit janë paraqitur edhe rekomandime sipas fushave të caktuara.

2. METODOLOGJIA

Raporti për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali ndjek metodologjinë e një strukture të njëjtë me Strategjinë, duke ofruar të dhënat që identifikojnë zbatimin e Strategjisë, në fushën e arsimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë, banimit dhe mos diskriminimit.

Këto të dhëna janë të paraqitura në raport, në formë narrative ose sasiore si dhe në formë statistikore, sipas objektivave strategjike dhe objektivave specifike të strategjisë.

Raporti është hartuar, mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga institucionet qendore dhe institucionet e nivelit lokal. Për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve

rom dhe ashkali 2022-2026 si dhe planit të veprimit 2022-2024, janë mbledhur të dhënat nga: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministria e Financave Punës dhe Transferove (MFPT), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Administrimit Pushtetit Lokal (MAPL) disa nga Komunat përkatëse si dhe Agjencioni i Punësimit në Republikën e Kosovës (APRK); në disa raste disa komuna dhe institucione të tjera, siç janë Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Akademia e Drejtësisë (AD), Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) etj.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport, janë të dhëna dhe informata të pranuar zyrtarisht nga institucionet e Kosovës. Për hartimin e raportit në fjalë, nuk është përdorur ndonjë metodologji e atillë e referencimit të dokumenteve të jashtme ose raporteve të tjera, për faktin se raporti është shkruar, sipas raportimit të dhënave zyrtare të institucioneve kompetent për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-20226 dhe planit të veprimit 2022-2024.

Struktura e trajtimit të të dhënave të mbledhura, është ndërtuar në mënyrën si në vijim:

- Është raportuar për secilën fushë që është pjesë e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-20226 dhe planit të veprimit 2022-2024;
- Struktura dhe raportimi i të dhënave është lidhur me objektivat strategjike dhe objektivat specifike të strategjisë, bazuar edhe në aktivitetet e planit të veprimit;
- Janë raportuar dhe elaboruar aktivitetet të tjera që ndërlidhen me objektivat e strategjisë dhe të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit të saj;
- Janë dhënë rekomandime të caktuara, kryesisht ndërlidhur me dimensionin e mospërmbushjes së objektivave të caktuara ose përmirësimit të zbatueshmërisë së Strategjisë dhe planit të veprimit;
- Zbatimi i strategjisë si dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport, janë ndërlidhur me prioritetet e përcaktuara në Deklaratën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve brenda procesit të zgjerimit të BE ose Deklarata e Poznanit, e vitit 2020.
- Në kuadër të metodologjisë së draftimit të këtij raporti, duhet të theksohet që pjesa më e madhe e komunave nuk ka raportuar të dhëna të sakta. Njëra nga komunat që ka raportuar të dhëna të plota për të gjitha fushat e strategjisë, përfshirë edhe ato statistikore është komuna e Podujevës, të dhëna këto të cilat janë integruar në raport.

Mbledhja e të dhënave është realizuar nga ZQM/ZKM në bashkëpunim të ngushtë me institucionet respektive, ku janë zhvilluar takime si dhe konsulta përmes formave të ndryshme. Të dhënat e pasqyruara në kuadër të këtij raporti, sipas sqarimit të dhënë nga institucionet përveç komuniteteve rom dhe ashkali, përfshijnë edhe komunitetet egjiptian në Republikën e Kosovës.

3. ARRITJET KRYESORE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI, 2022-2026 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024

Arsimi

Mësimi i gjuhës rome vazhdon të organizohet në komunën e Prizrenit, respektivisht në katër shkolla ku kanë marrë pjesë 100 nxënës. Për vitin 2023, është raportuar që komuna e Novobërdës ka angazhuar mësim plotësues në gjuhën rome ku janë angazhuar 13 nxënës, 7 djem dhe 6 vajza si dhe 2 mësimdhënës. Mësim plotësues për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali ka organizuar edhe komuna e Podujevës, ku kanë qenë të përfshirë 97 fëmijë, respektivisht 62 djem dhe 35 vajza si dhe 4 mësimdhënës. Kjo është një e dhënë shumë e rëndësishme në drejtim të përmbushjes së objektivave, të paraqitura në Deklaratën e Poznanit.

MASHTI ka ndarë gjithsej 467 bursa për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, gjatë vitit 2023, për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë ndarë 55 bursa përmes marrëveshjes në mes MASHTI dhe MAPL-së. Mentorimi për këta student do të zhvillohet nga VORAE-se, RomaVersitas dhe bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”.

Për vitin 2023 ka shpallur thirrje për financimin e OJQ-ve që drejtojnë qendrat mësimore që mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, që kontribuojnë në arritjen arsimore. Buxheti i planifikuar ka qenë në vlerë prej 200.000.00 euro. Në këtë thirrje kanë përfituar 7 OJQ me gjithsej 21 qendra mësimore. Po ashtu, kjo është një e dhënë shumë e rëndësishme në drejtim të përmbushjes së objektivave, të paraqitura në Deklaratën e Poznanit.

Me qëllim të luftimit të gjuhës së urrejtjes, MASHTI ka filluar të implementoj dhe adresoj çështjen e gjuhës së urrejtjes në tekstet shkollore, pas nxjerrjes së raportit Ex Officio, të Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje.

Në bashkëpunim me OSBE është hartuar një manual për Ndërkulturalizmin në Arsim dhe lidhur me këtë do të organizohen edhe trajnime me mësimdhënësit. Ndër të tjera janë hartuar edhe këto module nga MASHTI: Parandalimi i diskriminimit në shkolla; Promovimi i barazisë gjinore; Parandalimi i gjuhën së urrejtjes; Parandalimin e dhunës në familje; Parandalimi i trafikimit të fëmijëve; Parandalimi i ngacmimeve seksuale; Programi i iniciativës së të rinjve- Y Rinia; Parandalimi i martesave të hershme; Parandalimi i punës së fëmijëve.

Punësimi dhe Mirëqenia Sociale

Gjatë vitit 2023 kanë përfituar nga përfshirja në aftësim profesional në Qendrat për Arsim dhe Aftësim Profesional (QAP), gjithsej 57 kandidat, prej tyre 21 Rom, 24 Ashkali dhe 12 egjiptian. Buxheti nuk është i ndarë sipas komuniteteve, mirëpo vlera e kalkuluar për personat e përfshirë në trajnime ka një kosto rreth 12000 euro.

Gjatë vitit 2023 janë përfshirë 10 persona në praktikë në punë, prej tyre 1 rom, 5 ashkali dhe 4 Egjiptian. Buxheti për angazhimin e 10 personave nga gjatë (6) muaj në punë praktike ishte 10200 euro.

Një (1) milion euro janë ndarë për grante nga Ministria për Komunitet dhe Kthim për OJQ që kanë projekte për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali. Në anën tjetër, dy (2) milion euro nga kjo Ministri janë ndarë për bujq dhe biznese të vogla startup dhe nga ky grant kanë përfituar 111 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas të dhënave të APRK, gjatë 2023 janë ndërmjetësuar në punësim 104 persona, prej tyre 16 Rom, 44 Ashkali dhe 44 Egjiptian. Nuk ka pasur statistika të raportuara, në bazë të vendeve, respektivisht sektorëve se ku janë punësuar të njëjtit.

Ministria përkatëse përmes QPS-ve ka siguruar strehim familjar për të gjitha komunitetet, përfshirë fëmijët rom, ashkali dhe egjiptianë. Bazuar në të dhënat e databazës së Shërbimeve Sociale, gjatë vitit 2023, një numër i përgjithshëm prej 74 fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë vendosur në strehim familjar brenda familjes tek te afërmit, ndërsa 5 fëmijë janë vendosur në strehimin familjar alternativ jashtë familjes.

Po ashtu është realizuar pagesa për Skemën e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme 1-18 vjeç, për 122 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, me pagesë mujore 100 euro në muaj. Nga numri i përgjithshëm. 122, fëmijë përfitues, prej tyre rom janë 38 fëmijë, ashkali 62 dhe egjiptian 22 fëmijë. Buxheti i shpenzuar vetëm për komunitetet rom ashkali egjiptian për vitin 2023 është 146,400 euro.

Gjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë, ka krijuar dhe vazhdon ta forcojë partneritetin me OJQ-të të cilat kanë në programet e tyre: strehimin, trajtimin, përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje. 81 viktima të strehuara në këto strehimore janë nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian.

Për skemat e ndihmës sociale, gjatë vitit 2023, nga gjithsejtë 2,820 familje përftuese: rom janë 1,379 familje me 6,703 anëtar/e, ashkali janë 1,002 familje me 4,494 anëtar/e dhe egjiptian janë 439 familje me 2,050.

Shëndetësia

Sipas të dhënave të IKSHKP, në vitin 2023, përmes fushatës derë më derë, me qëllim të vaksinimit janë përfshirë 1287 familje të komuniteteve rom dhe ashkali. Nga këto familje në këtë proces janë përfshirë 5515 fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali.

QKMF Ferizaj ka raportuar se janë realizuar vizita, ku kanë marrë pjesë gjithësejt 100 pjesëtar të komunitetit rom dhe 86 pjesëtarë të komunitetit ashkali.

MSH ka mbajtur pesë (5) tryeza diskutimi me profesionistët shëndetësor (infirmier) të nivelit parësor lidhur me prezantimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe e drejta për shëndet e drejtë e njeriut e mbrojtura me Konventat Ndërkombëtare. Tryezat janë mbajtur në Kujdesin Parësor pasi që kontakti i parë i pacientit me mjekun është në nivel të kujdesit parësor shëndetësor.

Janë organizuar fushata vetëdijesuese për të drejtat e pacientit dhe mekanizmave përgjegjës për ankesa të komuniteteve rom dhe ashkali drejtuar punëtorëve shëndetësor dhe pjesëtarëve të komuniteteve. Lidhur me këto tryeza dhe mbajtjen e tyre, MSH raporton se ato si të tilla janë mbajtur në tri (3) Komuna, respektivisht në QKMF– Lipjan; QKMF –Podujevë; QKMF – Pejë. Tryezat kanë përfshirë 50 qytetare të komunitetit rom ashkali dhe egjiptian: udhëheqës i OJQ – ve , të këtij komuniteti. Po ashtu, QKMF në Pejë në bashkëpunim me PRAK, AQH, dhe Syri vizionit kanë realizuar katër (4) tryeza ku kanë marrë pjesë gjithsej 47 veta, pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali. QKMF në Obiliq ka raportua se ka mbajtur një (1) trajnim të kësaj natyre dhe kanë përfituar 25 persona, nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali.

Banimi

Janë mbajtur trajnime për zyrtarët komunal për funksionalizimin e platformës elektronike, data baza e banimit social. Ky trajnim është përkrahur nga RCC.

Po ashtu është bërë hartimi dhe aprovimi i Studimit të Fizibilitetit për Banim Social adekuat, në Republikën e Kosovës.

MMPHI, ka raportuar që janë ndërmarrë disa veprime që rezultojnë me ngritjen e komoditetit dhe cilësisë së jetës, për komunitetet rom dhe ashkali, në kuptim të përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese. Një çështje e rëndësishme në këtë aspekt është hartimi dhe aprovimi i Studimit të Fizibilitetit për Banim të Përbalueshëm në Kosovë.

Nga CEB-Banka është aprovuar kërkesa për kredi me interes të ulët prej 25.0 milion euro për bashkëfinancimin e Projektit të Banimit Adekuat Social. Pas një pune disa vjeçare me datë 25 janar 2024, është nënshkruar kjo marrëveshje për kredi, e cila ka për qëllim që të përmirësojë kualitetin e cilësisë së jetës të komuniteteve rom dhe ashkali. Në vitin 2024 pritet të bëhet ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky veprim në përmbushjen e strategjisë dhe planit të veprimit është shumë i rëndësishëm, në drejtim të përmbushjes së

përcaktimeve që dalin nga Deklarata e Poznanit, për zgjidhjen e problemit të banimit për çështjen e komuniteteve rom dhe ashkali.

Gjithashtu nga WBIF është fituar Grantin për Asistencë Teknike prej 2.08 milion Euro. Realizimi i bashkëpunimit me Asistenca Teknike 11 (IPF 11) për Programin Adekuat për Banim Social. Po ashtu edhe ky projekt pritet të ndikojë në përmirësimin e kualitetit të jetës së komuniteteve rom dhe ashkali.

MMPHI pas pranimit të Studimin e Fizibilitetit për Banim Social Adekuat për Kosovën, i cili u financua nga Banka Zhvillimore e Këshillit Evropës/Fondi Italian për Projekte Inovative dhe u zbatua nga UN-Habitat. Ky studim shërbeu si bazë për përafrimin dhe rishikimin e draft-ligjit për banim social dhe të përballueshëm me konceptet dhe rekomandimet e tij. Për të adresuar kërkesat pasuese, në prill të vitit 2023 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) kërkoi përkrahjen e UN-Habitat-it për mbështetje teknike në rishikimin dhe finalizimin e këtij ligji. Rrjedhimisht, UN-Habitat ofroi një ekip teknik, duke përfshirë specialistë në planifikimin hapësinor dhe urban, një ekspert ligjor dhe një këshilltar ndërkombëtar për banim: Besnike Koçani, Këshilltare për Planifikim Hapësinor dhe Urban, Alma Pacarizi, bashkëpunëtoreshë për Planifikim Hapësinor dhe Urban, Qerkin Berisha, Ekspert Ligjor dhe Matthias Nohn, Këshilltar ndërkombëtar për banim.

MMPHI, me mbështetjen e ekipit teknik të UN-Habitat-it dhe grupit punues, shqyrtoi draftin fillestar të përgatitur nga Grupi Punues, i cili përfshinte gjithashtu komentet dhe sugjerimet e mëhershme të UN-Habitat-it, i cili ka shërbyer si bazë për formulimin e një drafti të ri në përputhje me studimin e fizibilitetit. Ky draft u prezantua dhe u rafinua gjatë një punëtorie të organizuar me përkrahjen e UN-Habitat-it gjatë periudhës 17 deri 19 maj 2023. Të gjithë pjesëmarrësit e punëtorisë kanë dhënë sugjerime, komente dhe vërejtje të vlefshme. Pas përfundimit të kësaj punëtorie, është dërguar për komente finale nga MMPHI tek të gjithë pjesëmarrësit. Në vijim, Grupi Punues së bashku me Divizionin e Banimit dhe Zyra Ligjore e MMPHI, kanë bërë rishikimin final të këtij draft-ligji, si dhe e kanë hapur për konsultime me publikun. Vlen të ceket se ky projektligj përmban katër (4) Programe: programin për banim social programin për zhvillimin e lagjeve adekuate, programin për rindërtimin dhe renovimin e shtëpive dhe programin për banim të përballueshëm si dhe programe tjera që janë të lidhura me planifikim e banimit dhe urbanizmit që konsiderohen me interes publik si dhe grupet e synuara janë edhe komuniteti rome, ashkali dhe egjiptian. Pritet në qershor 2024 të dorëzohet në Qeveri.

Në kuptim të përmbushjes së kësaj objektive, rindërtimi dhe renovimi i shtëpive në Veri të Kosovës, për familjet që shtëpitë e tyre që janë dëmtuar në periudhën kohore 1998/99 dhe realizimi i rindërtimit, renovimit dhe qirave për familjet e riatdhesuara përbën një të arritur, në vitin 2023, në kuptim të përmbushjes së objektivave, të fushës së banimit, përkitazi me strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024.

Mbrojtja nga Diskriminimi

Në kuadër të fushës së mbrojtjes nga diskriminimi, një e arritur shumë e rëndësishme dhe kryesore, për vitin 2023, është suksesi i Grupit Teknik, i cili ka për mandat mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në kuadër të Grupit teknik, Platforma Kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ka adresuar me sukses, mbi dhjetë (10) raste të diskriminimit, përgjatë vitit 2023.

Për herë të parë, në kuadër të kësaj platforme, është vërtetuar me aktgjykim të gjykatës, mbrojtja nga diskriminimi e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve si dhe mbrojtja e diskriminimit është adresuar me sukses.

Suksesi i Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në luftimin e diskriminimit, ka përmbushur kënaqshëm një objektiv të Deklaratës së Poznanit, për ndërtimin e një mekanizmi për specifik që adreson rastet e diskriminimit.

4. PROGRESI NE BAZE OBJEKTIVAVE TE ZBATIMIT TE STRATEGJISE DHE PLANIT TE VEPRIMIT PER PERFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NE SHOQERINE KOSOVARE 2017-2021

4.1 Aktivitetet, të arriturat, sfidat dhe rekomandimet

4.1.1 ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E ARSIMIT

Njëra ndër objektivat strategjike, në fushën e arsimit që lidhet me Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024, është **Rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom dhe ashkali**. Kjo objektivë përfshinë tri objektiva specifike në përmbushjen e të cilave janë ndërmarrë veprime konkrete, nga MASHTI dhe institucionet e tjera kompetente.

Objektivat specifike të përmbushjes së strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024, në fushën e arsimit janë:

1. Vetëdijesimi dhe promovimi i rëndësisë së arsimimit dhe përfshirjes të fëmijëve nga komunitetet rom dhe ashkali në të gjitha nivelet e arsimit dhe tek të gjithë akterët relevantë;
2. Përmirësimi i performancës akademike të nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim;
3. Luftimi i diskriminimit, racizmit, stigmatizimit, gjuhës së urrejtjes, dhunës së urrejtës dhe bullizmit; në shkolla dhe promovimi i kulturës dhe historisë së komuniteteve rom dhe ashkali.

Zbatimi i Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024, në sektorin e arsimit do të trajtohet në kuptimin e objektivave specifike ndërlidhur me Planin e veprimit dhe aktivitetet në planin e veprimit, në kuadër të strategjisë. Përsa i përket objektivës specifike që ka të bëjë luftimin e diskriminimit, e njëjta do të pasqyrohet në seksion të veçantë të këtij raporti.

Objektiva strategjike 1: Rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom dhe ashkali dhe aktivitetet e planit të veprimit

Në kuadër të objektivës strategjike 1, plani i veprimit ka paraparë 11 aktivitete dhe veprime të caktuara, të cilat janë përmbushur dhe për të cilat janë ndërmarrë veprime konkrete në zbatimin e

aktiviteteve të tij. Për zbatimin e aktiviteteve, në kuadër të kësaj objektive janë organizuar katër (4) sesione informuese me prindërit e komuniteteve për lehtësimet që ofrohen me UA 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore, më qëllim të informimit për të drejtat që këto komunitete i kanë për tu regjistruar në institucionet parashkollore. Sesionet janë mbajtur në 3 komuna dhe atë në: Fushë Kosovë, Gjakovë dhe Ferizaj. 14 fëmijë të komunitetit ashkali dhe 2 rom kanë përfituar nga udhëzimi administrativ për lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve në arsimin e mesëm të lartë në komunën e Podujevës.


Sipas SMIA-MASHTI të dhënat e regjistruara në vitin akademik 2023/2023 përfshijnë tregues specifik gjinor për shumicën e të dhënave themelore siç janë regjistrimi I nxënësve;

2023-2024

Nr. i nxënësve rom,	1.157
Nr. i nxënësve ashkali	1.279
Nr. i nxënësve egjiptian	4000

Total: 6436

Tabela: Sipas SMIA-MASHTI të dhënat e regjistruara në vitin akademik 2023/2024



- **Subvencionimit i pagesave të çerdhes për rritjen e përfshirjes të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në kopshtet e reja që do të ndërtohen në komunat me koncentrim me të lartë të komuniteteve në fjalë**

Bazuar në informatat që kanë dhënë DKA-të, lidhur me subvencionimin e fëmijëve të komuniteteve rom, nuk rezulton të ketë pasur kërkesa për subvencionimin e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali. Rezulton që ky aktivitet, në kuadër të objektivës strategjike 1, në fushën e arsimit, të mos ketë pasur rezultate konkrete, në kuptimin e përbushjes.

- **Ngritja e kapaciteteve, apo mbështetje institucionale për Ekipet për Parandalimin e Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Shkollë (EPRMB) në zbatimin e planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit në të gjitha komunat**

Sa i përket parandalimit dhe reagimit ndaj braktisjes së shkollës, MASHTI ka vazhduar mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave. Në këtë drejtim, MASHTI ka përkrahur funksionimin e ekipeve dhe hartimin e planeve komunale për 15 komuna, si dhe ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme rekomandime specifike për rastet e identifikuara, përsa i përket parandalimit dhe braktisjes në shkolla. Lidhur me përbushjen e këtij aktiviteti MASHTI ka ofruar disa module si në vijim: **Parandalimi i diskriminimit në shkolla; Promovimi i barazisë gjinore; Parandalimi i gjuhën së urrejtjes; Parandalimin e dhunës në familje; Parandalimi i trafikimit të fëmijëve; Moduli 9. Parandalimi i ngacmimeve seksuale; Programi i iniciativës së të rinjve- Y Rinia dhe Parandalimi i martesave të hershme; Moduli 12. Parandalimi i punës së fëmijëve.** MASHTI është duke vazhduar në promovimin e këtyre moduleve në komuna dhe shkolla të ndryshme. Është raportuar se në komunën e Podujevës janë organizuar 4 trajnime për ngriten e kapaciteteve për ekipet për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit.

Nxënësit Rom, Ashkalinjë dhe Egjiptianë sipas nivele, viti shkollor 2023/24.

Niveli	Ashkalinjë			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Arsimi parashk./parafill. (mosha 0-<6)	92	92	184	53	41	94	37	28	65	182	161	343
Fillor/ mesem i ulët	1883	1778	3661	543	482	1025	511	543	1054	2937	2803	5740
I mesem i lartë	98	57	155	14	24	38	85	75	160	197	156	353
Gjithsej	2073	1927	4000	610	547	1157	633	646	1279	3316	3120	6436

Nxënës braktisës, në gjysmëvjetorin I (parë), 2023/24

Klasë	Ashkalinjë			Romë			Egjiptianë			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Kl. 1-9	7	15	22	14	0	14	8	6	14	29	21	50
Kl. 10-12	1	1	2	0	1	1	0	1	1	1	3	4
Gjithsej	8	16	24	14	1	15	8	7	15	30	24	54

- Zgjerimin e organizimit të mësimit plotësues të gjuhës rome në 4 komuna**

Mësimi i gjuhës rome vazhdon të organizohet në komunën e Prizrenit, respektivisht në katër shkolla ku kanë marrë pjesë 100 nxënës. Për vitin 2023, është raportuar që komuna e Novobërdës ka angazhuar mësim plotësues në gjuhën rome ku janë angazhuar 13 nxënës, 7 djem dhe 6 vajza si dhe 2 mësimdhënës. Mësim plotësues për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali ka organizuar edhe komuna e Podujevës, ku kanë qenë të përfshirë 97 fëmijë, respektivisht 62 djem dhe 35 vajza si dhe 4 mësimdhënës.

- **Ndarja e 500 bursave në baza vjetore për nxënësit e komuniteteve rom dhe ashkali që vijnë shkollën e mesme të lartë që do të jetë 300 euro në vit mësimor (duke përfshirë edhe komunitetin egjiptian)**

Programi i bursave është proces që planifikohet dhe realizohet çdo vit shkollor nga viti 2014, prandaj edhe këtë vit shkollor 2023/2024, sikurse viteve më herët ka vazhduar programi i bursave. Fillimisht është shpallur konkursi për bursa për këtë vit shkollor për nxënësit e shkollave të mesme të larta për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. MASHTI ka planifikuar 500 bursa – 150.000 euro ndërsa për vitin shkollor 2023/24 kanë përfituar 467 nxënës.

Përfituesit e bursës në vitin 2023/2024

Nr.	Përfituesit	Rom		Ashkali		Egjiptian			
		F	M	F	M	F	M		
	467	46	31	99	103	99	89		

Po ashtu, gjatë vitit 2023, për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë ndarë 55 bursa përmes marrëveshjes në mes MASHTI dhe MAPL-së. Mentorimi për këta student do të zhvillohet nga VORAE-se, RomaVersitas dhe bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”.

- **Mentorimi i 50 studentëve nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali**

Sipas të dhënave të MASHTI, mentorimi i studentëve nga radhët e komuniteteve është realizuar nga OJQ Roma Versitas Kosova. Nga raportimi që ka ardhur nga komunat, përveç kësaj të dhëne të pranuar nga MASHTI, rezultojnë që 20 persona të komunitetit ashkali, 2 të komunitetit Egjiptian dhe 5 të komunitetit rom, kanë përfituar nga mentorimi në komunën e Podujevës.

- **Hulumtimi i nevojave për arsimimin e të rriturve nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali**

Arsimi për të rritur apo arsimi joformal organizohet nga shkollat varësisht nga kërkesa që janë paraqitur, mirëpo nga MASHTI nuk ka pasur të dhëna për një gjë të tillë.

- **Promovimi për mundësitë e arsimimit dhe aftësimin profesional (materiale promovuese), organizimi i fushatave vetëdijesuese si pjesë e orientimit për karrierë për nxënësit e klasave të 9-ta.**

Gjatë vitit 2023 janë bërë planifikimet dhe në bashkëpunim me Save the Children. Lidhur me këtë aktivitet në vitin 2024 do të fillojë implementimi i projektit Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme në Kosovë, përmes qasjes me te mire dhe të barabartë në tregun e punës", i cili ka për qëllim të

mbështesë komunitetet rom dhe ashkali, në arsim dhe aftësim profesional dhe nxënësit e klasave 6-9 për orientim në karrierë.

- **Organizimi i programeve të lexim-shkrimit për të rriturit (50 vijues) nga komunitetet rom dhe ashkali**

Organizimi i programeve të shkrim-lexim bëhet në Prishtinë por për numrin e pjesëmarrësve nuk ka informacione të raportuara. Ky aktivitet realizohet në bazë kërkesave individuale apo grupe në nivel të komunave. Janë organizuar aktivitete dhe plan programe të shkrim leximit, ku kanë përfituar 27 pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Podujevës.

- **Rritja e përfshirjes pjesëtarëve të komuniteteve rom, dhe ashkali në programet e aftësimit profesional (konsultohet me arsimin profesional)**

Gjatë vitit 2023, siç u tha më lartë janë bërë planifikimet dhe në bashkëpunim me Save the Children, që në vitin 2024 të fillojë implementimi i projektit “Fuqizimi i komuniteteve të cenueshme në Kosovë, përmes qasjes me të mirë dhe te barabarte në tregun e punës”, i cili ka për qëllim të mbështesë komunitetet rom dhe ashkali, në fushën e arsimit profesional. Kjo është theksua edhe më lartë. Në programet e aftësimit profesional janë përfshirë 19 pjesëtar të komuniteteve rom dhe ashkali për komunën e Podujevës.

- **Sigurimi i materialëve shkollorë për nxënësit komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rastet sociale në arsim të obligueshëm**

MASHTI për vitin shkollor 2023/2024 ka rimbursuar me mjete financiare prindërit për të siguruar tekstet shkollorë dhe mjetet mësimore për klasat 1-5 dhe 6-9, për nxënësit në arsimin e detyrueshëm. Për klasat 1-5 janë rimbursuar nga 50 euro për nxënës dhe për klasat 6-9 janë rimbursuar nga 30 euro për mjete mësimore. Në këtë rast kanë përfituar edhe fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali.

Objektiva Specifike 1: Vetëdijesimi dhe promovimi i rëndësishëm së arsimimit dhe përfshirjes të fëmijëve nga komunitetet Rom dhe Ashkali në të gjitha nivelet e arsimit dhe tek të gjithë akterët relevantë dhe aktivitetet e planit të veprimit

Në kuadër të objektives specifike 1, plani i vapimit ka paraparë pesë (5) aktivitete dhe veprime të caktuara, të cilat janë përmbushur dhe për të cilat janë ndërmarrë veprime konkrete në zbatimin e aktiviteteve të planit të veprimit:

- **Mbështetja në regjistrimin e 20 qendrave mësimore**

Deri më tani janë gjithsej 52 qendra mësimore të regjistruara. Nga dhjetori i vitit 2023 kanë filluar të aplikojnë rreth 21 qendra mësimore për ri-regjistrim, të cilat do të shqyrtohen nga komisioni për regjistrim i MASHTI. Janë mbështetur 4 qendra mësimore për komunitetet rom dhe ashkali në komunën e Podujevës.

- **Mbështetja e 30 qendrave mësimore të regjistruara në bazë të udhëzimit administrativ**

Sipas Udhëzimit administrativ 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, MASHTI, sipas nenit 13 (Financimi dhe buxheti) pika 2.1 planifikon buxhetin vjetor për mbështetje të programeve të aprovuara të qendrave mësimore. Andaj, bazuar në këtë UA MASHTI –Divizioni për Arsimin e Komuniteteve, nga viti 2021 ka filluar të zbatoj nenin 13 pikën 2.1 për financimin e OJQ-ve. Respektivisht për vitin 2023 ka shpallur thirrje për financimin e OJQ-ve që drejtojnë qendrat mësimore që mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, që kontribuojnë në arritjen arsimore. Buxheti i planifikuar ka qenë në vlerë prej 200.000.00 euro. Në këtë thirrje kanë përfituar 7 OJQ me gjithsej 21 qendra mësimore.

- **Rishikimi i plan programeve teksteve ekzistuese të gjuhës rome dhe hartimi i teksteve të reja në gjuhën rome**

Sipas të dhënave nga MASHTI, ky proces nuk ka filluar ende për arsye se ka qenë e planifikuar të filloj në vitin 2024 me mbështetjen e Këshillit të Evropës (KiE) me projektin e ri katër (4) vjeçar. Nuk ka akoma një datë të saktë se kur do të fillojë saktësisht ky projekt.

- **Organizimi i fushatave për vetëdijësimin e prindërve rom dhe ashkali lidhur me rëndësinë dhe mundësitë të edukimit në fëmijërinë e hershme (15 komuna 1 herë në vit)**

Janë organizuar 4 sesione informuese me prindërit e komuniteteve për lehtësimet që ofrohen me UA për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore, më qëllim të informimit për të drejtat që i kanë komunitetet rom dhe ashkali, në institucionet parashkollore. Sesionet janë mbajtur në 3 komuna si: Fushë Kosovë, Gjakovë dhe Ferizaj.

- **Sigurimi i pozitave të ndërmjetësuesve në arsim në minimum 7 komuna me koncentrim më të lartë të komuniteteve rom dhe ashkali për të ulur mosregjistrimin dhe braktisjen, dhe për të ngritur vetëdijësimin për rëndësinë e arsimit dhe kundërdiskriminimit**

Për realizimin e këtij aktiviteti, përpos aspekteve që janë përmendur më sipër, nuk janë raportuar ndonjë e dhënë konkrete statistikore, që dëshmon veprimet e ndërmarra në uljen e mosregjistrimit dhe braktisjes në shkolla.

Objektiva Specifike 2: Përmirësimi i performancës akademike të nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim

Kjo objektive specifike realizohet mbi bazën e dy (2) veprimeve konkrete të përcaktuara në planin e veprimit, për realizimin e të cilave janë ndërmarrë veprimet e mëposhtme.

- **Rishikimi/plotësimi i teksteve shkollore të Shoqërisë dhe mjedisit përmes qasjes së përfshirjes së dimensioneve kulturore dhe historike të komuniteteve jo-shumicë, me qëllim të eliminimit të gjuhës përjashtuese dhe diskriminuese dhe zëvendësimit të saj me gjuhë gjithëpërfshirëse.**

MASHTI ka përkrahur hulumtimin mbi gjuhën e përdorur në tekste shkollore. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka realizuar dhe publikuar raportin Ex-officio për gjuhën e përdorur në tekstet mësimore të arsimit të mesëm të ulët, në gusht të vitit 2023. Në këtë raport të IAP është konstatuar që tekstet nuk janë diskriminuese. Tutje, IAP ka adresuar tek MASHTI emailin njoftues që të njëjtin hulumtim do ta vazhdojnë edhe për tekstet e klasave 10, 11 dhe 12.

- **Përgatitja e materialeve e teksteve që mund të ndahen si module të veçanta për historinë dhe kulturën e komuniteteve rom dhe ashkali në lëndë zgjedhore (deri në rishikimin e teksteve relevante shkollore).**

Në bashkëpunim me OSBE është hartuar një doracak për Ndërkulturalizmin në Arsim dhe lidhur me këtë do të organizohen edhe trajnime me mësimdhënësit. Ndër të tjera janë hartuar edhe këto module nga MASHTI: Parandalimi i diskriminimit në shkolla; Promovimi i barazisë gjinore; Parandalimi i gjuhës së urrejtjes; Parandalimin e dhunës në familje; Parandalimi i trafikimit të fëmijëve; Parandalimi i ngacmimeve seksuale; Programi i iniciativës së të rinjve- Y Rinia; Parandalimi i martesave të hershme; Parandalimi i punës së fëmijëve.

4.1.1.1 Rekomandimet për zbatimin e strategjisë në fushën e arsimit

- Të ndërmerren masa për të rezultuar subvencionimin e pagesave për çerdhet dhe kopshtet për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali.
- Rekomandohet që të zhvillohet një hulumtim më gjithëpërfshirës, i nevojave për arsimin e të rriturve tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali.
- MASHTI të ndërmarrë veprime sipas kompetencave, për të filluar rishikimin e planprogrameve mësimore në gjuhën rome.
- Të ndërmerren më shumë veprime në lidhje me uljen mosbraktisjes në shkolla, për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal. Këto

veprime do të ndihmonin edhe përmbushjen e përcaktimeve të Deklaratës së Poznanit, në mënyrë që të rritet shkalla e regjistrimit dhe përfundimit të mësimit për komunitetet rom dhe ashkali në 50%.

- Institucionet e Republikës së Kosovës, të nivelit qendror dhe lokal, në kuadër të përmbushjes së objektivave strategjike dhe specifike si dhe aktiviteteve të planit të veprimit, të ndërmarrin veprime që të përmbushin përcaktimet e Deklaratës së Poznanit për rritjen e regjistrimit të romëve në arsimin fillor, për 90%; Rritjen e shkallës së përfundimit të romëve në arsimin fillor për 90%, duke parandaluar braktisjet e shkollave.

4.2. ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E PUNËSIMIT DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Fusha e punësimit dhe mirëqenies sociale në kuadër të strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali është e përbërë nga një objektivë strategjike dhe tri (3) objektiva specifike. Objektiva strategjike e kësaj fushe është Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom dhe ashkali, kurse objektivat specifike janë:

1. Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimin profesional;
2. Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes sensibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali si dhe masave stimuluese për punëdhënës;
3. Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara nga ligji.


Objektiva strategjike 1: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom dhe ashkali

Objektiva specifike 1: Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimin profesional si dhe aktivitetet e planit të veprimit në fushën e mirëqenies sociale

Objektiva e parë specifike ka tetë (8) aktivitete të planit të veprimit, të cilat kanë shërbyer për zbatimin e objektivës strategjike dhe specifike, në fushën e mirëqenies sociale, në kuptimin e zbatimit të strategjisë, për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 202-2024 dhe planit të veprimit 2022-2024.

- **Nxitja e regjistrimit dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale konform nevojave të tregut të punës**

Gjatë vitit 2023 kanë përfituar nga përfshirja në aftësim profesional në Qendrat për Arsim dhe Aftësim Profesional (QAP), gjithsej 57 kandidat, prej tyre 21 rom, 24 ashkali dhe 12 egjiptian. Buxheti nuk është i ndarë sipas komuniteteve, mirëpo vlera e kalkuluar për personat e përfshirë në trajnime ka një kosto rreth 12000 euro.



- **Analiza e ndikimit të subvencionimit në punësim afatgjatë të komuniteteve rom dhe ashkali në sektorin privat**

Gjatë 2023 janë përfshirë 23 persona në masën aktive; subvencionim në pagë, prej tyre 5 rom, 6 ashkali dhe 12 egjiptian. Buxheti për angazhimin e 23 personave nga gjashtë (6) muaj në subvencionim pagë është 23,460 euro.

- **Angazhimi pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në praktikë në punë dhe në institucione të nivelit qendror dhe lokal. 8 (2 rom, 6 ashkali) kandidat x150)**

Gjatë vitit 2023 janë përfshirë 10 persona në Masën aktive; praktikë në punë, prej tyre 1 rom, 5 ashkali dhe 4 Egjiptian. Buxheti për angazhimin e 10 personave nga gjatë (6) muaj në punë praktike është 10200 euro.

- **Angazhimi pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në trajnim në punë (kosto për kandidat 3x170)**


Në trajnime për punë janë angazhuar 18 pjesëtar të komunitetit rom dhe ashkali në Komunën e Podujevës. Në këtë aspekt nuk ka pasur raportime të tjera.

- **Ndarja e shumave për komunitetet rom dhe ashkali nga fondi për grantet për vetëpunësim/startup, me fokus fuqizimin e grave në biznes dhe punësimin (kuota e granteve për komunitetet rom dhe ashkali 30%, kosto për kandidat 3000 euro)**

Një (1) milion euro janë ndarë për grante nga Ministria për Komunitet dhe Kthim për OJQ që kanë projekte për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali. Në anën tjetër, dy (2) milion euro nga kjo Ministri janë ndarë për bujq dhe biznese të vogla startup dhe nga ky grant kanë përfituar 111 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Rritja e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërmjetësimit në punësim

Sipas të dhënave të APRK, gjatë 2023 janë ndërmjetësuar në punësim 104 persona, prej tyre 16 Rom, 44 Ashkali dhe 44 Egjiptian.



- **Fushatë vetëdijesuese për ofrimin e shërbimeve të punësimit përmes SIMP sistemi informativ i menaxhimit të punësimit përmes kampanjave, fletëpalosjes, TV programeve dhe bashkëpunimit me QPS që mund t'i drejtojnë përfituesit e skemave sociale të regjistruhen si punëkërkuës aktivë**

Në bashkëpunim me shoqata përfaqësuese të komuniteteve rom dhe ashkali, janë informuar dhe nxitur pjesëtar të këtyre komuniteteve për tu përfshirë dhe për të përfituar nga shërbimet dhe masat aktive të tregut të punës të implementuara nga APRK. Nuk është raportuar për statistika konkrete të përmbushjes së këtij aktiviteti të objektivës strategjike dhe specifike 1, përveç Komunës së Podujevës, ku janë përfshirë 12 pjesëtarë të komunitetit rom dhe ashkali.

- **Organizimi i takimeve informuese me përfaqësues të komuniteteve rom dhe ashkali**

Sipas të dhënave të APRK, për aftësim profesional, VoRAE ka organizuar takime informuese në zona rurale për përfshirje të pjesëtarëve të komuniteteve në trajnime në QAP.

- **Vlerësim mbi të gjendjen aktuale dhe potencialit të punësimit mes komuniteteve rom dhe ashkali në komunat relevante**

APRK dhe institucionet e tjera raportuar, nuk kanë theksuar ndonjë të dhënë lidhur me potencialin e punësimit në mes të komuniteteve rom dhe ashkali. Në nivelin komunal, 4 nga këto lloje të trajnimeve janë raportuar në Komunën e Podujevës.

Objektiva specifike 2: Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes sensibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali si dhe masave stimuluese për punëdhënës

- **Ngritja e kapaciteteve të punëtorëve socialë mbi rëndësinë e luftimit të diskriminimit, trajtimit të barabartë dhe qasjes drejtë zgjidhjeve të qëndrueshme për përfituesit në shërbime Sociale në 7 rajonet e Kosovës**

Gjatë vitit 2023, KPSHSF i cili ka për mandat zhvillimin e punëtorëve social, profesionisteve ofrues të shërbimeve sociale familjare, me mbështetjen Organizatave Joqeveritare QKRMT dhe Save dhe Children ka zhvilluar dhe organizuar trajnime me 6 module. Trajnimi në të gjitha rajonet e Kosovës. Modulet janë ofruar bazuar në kriteret e AKK duke përfshirë edhe procesin e vlerësimit të kandidatëve për secilin modul.

Gjatë vitit 2023, janë trajnuar gjithsejtë 473 ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare të sektorit publik dhe jo qeveritar me 6 module të trajnimit pa dallim etnie, për të gjithë punëtorët social në Kosovë. Duhet të theksohet se të gjithë përfituesit nuk kanë qenë nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali. Buxheti i planifikuar vetëm për komunitetet rom, ashkali 3000 euro.

- **Mbështetja Financiare e komuniteteve rom dhe ashkali përmes përfshirjes në skemat e mirëqenies sociale**

Për realizmin e këtij aktiviteti, janë ndërmarrë veprime konkrete, si: Zhvillimi programit për dy strehimet familjare: strehimin familjare brenda familjes, strehimin familjar alternativ, jashtë familjes, si dhe në skemën e SFFAKP.

Ministria përkatëse përmes QPS-ve ka siguruar strehim familjar për të gjitha komunitetet, përfshirë fëmijët rom, ashkali dhe egjiptianë. Bazuar në të dhënat e databazës së Shërbimeve Sociale, gjatë vitit 2023, një numër i përgjithshëm prej 74 fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë vendosur në strehim familjar brenda familjes tek të afërmit, ndërsa 5 fëmijë janë vendosur në strehimin familjar alternativ jashtë familjes.

Nga gjithsej 74 fëmijë, 21 janë rom, 30 ashkali, 23 egjiptian, është realizuar pagesa mujore është 150 euro, në muaj për një fëmijë. Ndërsa tek strehimi familjar alternativ jashtë familjes, janë të strehuar 5 fëmijë te komunitetit rom dhe pagesa mujore për këta fëmijë, gjatë vitit 2023 është realizuar 350 euro në muaj. E njëjta situatë është edhe me strehimin familjarë alternative, jashtë farefisit, deri në qershor janë paguar 250 në muaj, nga qershori 2023 350 euro në muaj, buxheti i shpenzuar është 18,500 euro.

Buxheti i planifikuar vetëm për komunitetin rom dhe ashkali, në strehim familjar brenda familjes është i përcaktuar në planin e veprimit të strategjisë, ndërsa buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2023 114,700 euro, meqenëse deri në muajin qershor 74 fëmijë në strehim familjar brenda familjes janë paguar 100 euro në muaj, ndërsa nga qershori ka filluar pagesa me rritje 150 euro.

Po ashtu është realizuar pagesa për Skemën e Familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme 1-18 vjeç, për 122 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, me pagesë mujore 100 euro në muaj. Nga numri i përgjithshëm përfitues janë 122 fëmijë, prej tyre rom janë 38 fëmijë, ashkali 62 dhe egjiptian 22 fëmijë. Buxheti i shpenzuar vetëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për vitin 2023 është 146,400 euro.

- **Informimi dhe vetëdijesimi i komunitetit përmes fushatave të ndryshme (TV, broshura, komunikimet me zyrtar me komunitetin) për mundësinë e marrjes dhe llojeve të shërbimeve sociale**

Në çdo QPS dhe institucione përkatëse, ekzistojnë fletushka informuese si për ofrimin e shërbimeve sociale, ashtu edhe për të drejtat e përfituesve në asistencë sociale, shërbime sociale dhe të gjitha kategoritë sociale dhe format e mbrojtës për qytetarët në nevojë sociale për të gjitha komunitetet në veçanti për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Buxheti i planifikuar vetëm për komunitetet rom dhe ashkali është 3000 euro.

- **Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes institucionale për komunitetet**

Bazuar në strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, vendosja/strehimi i personave pa përkujdesje familjare në strehim rezidencial në institucione dhe shtëpi të komuniteteve, konsiston në ofrimin e shërbimeve 24 orë-she duke përfshirë: strehimin, ushqimin, veshmbathjen, ofrimin e shërbimeve shëndetësore, akomodimin dhe të gjitha shërbimet e tjera të vlerësuara si të nevojshme për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara, prapambetje mendore.

Në kuadër të këtij veprimi, janë ofruar shërbime rezidenciale 24-orë për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara nga Instituti Special në Shtime, Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë dhe trembëdhjetë (13) Shtëpi të komuniteteve në shtrirje nëpër komunat e Kosovës. Nga këto shërbime rezidenciale kanë përfituar mbi 275 rezidentë të vendosur në këto institucione nga të gjitha komunitetet pa dallim etnie. Nga komuniteti rom, kanë përfituar 8 rezident, 7 në institucione rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara, me prapambetje mendore dhe 1 (një) në shtëpinë

për persona të moshuar, ndërsa nga komuniteti ashkali, egjiptian nuk ka pasur përfitues për vitin 2023. Buxheti shpenzuar për këta persona, lidhur me këtë aktivitet është 96,000 euro.

- **Mbështetja e OJQ- ve të licencuara nga ministria përkatëse ne ofrimin e shërbimeve sociale familjare te komuniteteve rom dhe ashkali**

Për vitin 2023, nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk ka pasur Organizata Joqeveritare të Licencuara, në ofrimin e shërbimeve sociale familjare për arsye të mos aplikimit të tyre për licencim. Buxheti i planifikuar vetëm për komunitetet rom, ashkali lidhur me këtë aktivitet është për vitin 2023 ishte 100,000 euro, kurse buxhet të shpenzuar nuk ka pasur, për shkak të mungesës së organizatave joqeveritare të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

- **Nënshkrimi i 10 MeM-ve mes OJQ dhe Strehimoret për Fuqizimi i bashkëpunimit dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe grave nga komunitetet rom dhe ashkali, viktima te dhunës ne familje**

Gjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me të gjitha strehimoret në nivel nacional, regjional. Të gjitha këto strehimore gjatë vitit 2023 kanë strehuar dhe kanë trajtuar me shërbime të nevojshme viktimat e dhunës në familje të të gjitha moshave nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Gjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë, ka krijuar dhe vazhdon ta forcojë partneritetin me OJQ-të të cilat kanë në programet e tyre: strehimin, trajtimin, përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje. 81 viktima të strehuara ne këto strehimore janë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

- **Ofrimi i ndihmave sociale për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali përmes shkëmes së ndihmave sociale,**

Skema e ndihmave sociale menaxhohet nga Qendrat për punë sociale, vendimmarrja në përzgjedhjen e rasteve nga QPS ndërsa sigurimi i buxhetit nga MFPT. Në vitin 2023 2,820 familje me 12,247, anëtar/e të familjes kanë përfituar të drejtën në Skemën e ndihmave Sociale nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptian për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, nga gjithsejtë 2,820 familje përftuese: rom janë 1,379 familje me 6,703 anëtar/e, ashkali janë 1,002 familje me 4,494 anëtar/e dhe egjiptian janë 439 familje me 2,050.

Buxheti planifikuar për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, për këtë veprim është 5,000,000 euro, ndërsa buxheti i shpenzuar për vitin 2023 është 4,844,280 euro.

- **Ofrimi i ndihmave emergjente për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali**

Në vitin 2023, 2,820 familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, kanë përfituar subvencione për shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike si dhe nga Skemat e Ndihmës Sociale.

MFPT/DSS dhe QPS për familjet që janë përfutuese të Skemës së Ndhmës Sociale dhe familjet tjera që i plotësojnë kriteret e parapara me Udhëzim administrativ për ndihme të njehershme, e realizojnë këtë ndihmë financiare në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë ceremonitë e varrimit për anëtarët e familjes, dëmtimi i shtëpisë së shkaktuar nga zjarri, tërmeti ose përmbytje. Shuma e përfitimit për këto familje nga kjo skemë janë nga 100 Euro deri në 300 euro dhe jepet vetëm një herë në vit për të njëjtën nevojë/kërkesë.

Gjithsej 19, familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar nga kjo skemë gjatë vitit 2023. Buxheti i ndarë vetëm për komunitetet rom, ashkali, egjiptian është 10,000 euro në vite ndërsa buxheti i shpenzuar është 4,750 euro,

- **Organizimi i takimeve të rregullta të Tryezave për Ndhmë në Menaxhim të Rasteve (TNMR-ve) në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik të mesëm apo të lartë.**

Lidhur me këtë aktivitet, profesionistët e shërbimeve sociale, organizojnë tryeza multidisiplinare dhe bashkëpunojnë me shkollat, policinë, gjykatat. Prokurorinë, qendrat e shëndetit mendor, strehimoren shtetërore, OJQ-Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, shërbimin sprovues, puna me familjet për bashkim familjar. Qëllimi i takimeve është mbrojtja e interesit me të mirë të fëmijëve dhe të rriturve që bie në mandatin e tyre. Mbrojtja e interesave të fëmijëve dhe të rriturve nga Organi i kujdestarisë në QPS kompetente në nivel vendi që kanë për mandat mbrojtën e tyre realizohet sipas legjislacionit në fuqi.

7.1.3. Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara nga ligji

Me miratimin e Ligjit për Zyrtaar Publik është shënuar një progres në aspektin e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në institucionet publike. Rregullorja për Pranimin e Zyrtaarëve Publik është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës me 27.10.2023. Neni 13.4 i kësaj rregulloreje mundëson shpalljen e konkursit vetëm për komunitetet e ndër përfaqësuar. Raportohet që Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka kërkuar që deri në fund të janarit 2024 që të identifikohen dhjetë (10) pozita punë, që do të shpallen për komunitetet.

Nga të dhënat e raportuara, duhet theksuar se aktualisht komunitetet në FSK përfaqësohen me 182 ushtarakë apo shprehur në përqindje 4.3%. Prej të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve, 40 janë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, respektivisht 27 ashkali, 10 egjiptian, dhe 3 rom.

4.2.1. Rekomandimet në zbatimin e strategjisë në fushën e punësimit dhe të mirëqenies sociale

- Duhet të ndërmerren masa avokuese dhe të tjera që pjesëmarrja e komuniteteve rom dhe ashkali, në trajnim në punë të rritet dhe një gjë e tillë mund të bëhet përmes një bashkëpunimi me të theksuar ndërinstytucional edhe me shoqërinë civile.

- Të ndërmerren masa konkrete më të theksuara për përmbushjen e objektivës strategjike dhe specifike 1, për përfshirjen e grave të komuniteteve rom dhe ashkali, në biznes, përmes mbështetjes dhe granteve për bizneset startup.
- Të ndërmerren masa konkrete, për përfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali por edhe Egjiptian, në arsimin profesional, mes, qëllim të integritimit në tregun e punës, duke përfituar nga programet e QAP.
- Institucionet qëndrore dhe lokale, të kenë parasysh që gjatë punësimit në sektorin publik, t'i japin përparësi, në mënyrë afirmative, punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.
- Të ketë angazhim dhe koordinim të institucioneve si dhe pjesëtarëve të komuniteteve, që të licencohen Organizatat Joqeveritare nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali për t'i ofruar shërbimet sociale dhe familjare.

4.3. ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Zbatimi i Strategjisë për avancim e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe Planit të veprimit, 2022-2024, në fushën e shëndetësisë, për vitin 2023, vlerësohet në bazë të objektivave strategjike dhe atyre specifike. Në këtë fushë në kuadër të strategjisë është paraqitur një objektive strategjike dhe tri objektiva specifike.

Objektiva strategjike, në fushën e shëndetësisë është përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore. Kurse objektivat specifike janë:

1. Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore cilësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali;
2. Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit;
3. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali.
4. Objektiva Strategjike Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore.

Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore cilësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali

Objektiva Specifike 1: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit si dhe Aktivitetet e planit të veprimit në fushën e shëndetësisë

- **Hulumtim për gjendjen shëndetësore dhe kënaqshmërinë me marrjen e shërbimeve shëndetësore të komuniteteve rom dhe ashkali**

Nga të dhënat e raportuara prej MSH, rezulton që hulumtimi është kryer dhe IKSHPK ka dërguar të dhënat në ASK për realizimin e këtij hulumtimi.

QKMF – Ferizaj ka raportuar se janë realizuar hulumtimi për kënaqshmërinë me marrjen e shërbimeve shëndetësore të pacientëve të tërë pacientëve, pa i ndarë ato sipas komuniteteve, duke përfshirë edhe komunitetet jo shumicë, rom dhe ashkali.

- **Ofrimi i shërbimeve të mamografisë mobile, (5 komuna, 1 herë në vit, 30 ditë për komunë) (Nafta, materialet, rryma, ushqimi).**

QKMF Fushë Kosovë ka raportuar se janë realizuar 6 mamografi për gratë e komunitetit rom dhe ashkali.

Nga QKMF Ferizaj janë implementuar aktivitete në ofrimin e shërbimeve të mamografisë statike, ku kanë përfituruar gjithsej 15 gra rom dhe 25 gra të komunitetit ashkali.

QKMF Obiliq ka raportuar se në bashkëpunim me DSHMS Prishtinë janë udhëzuar pacientet nga Komuna e Obiliqit për mamografi në QKMF Prishtinë. Sa i përket numrit të mamografive të realizuara nuk janë raportuar të dhëna QKMF Prishtina.

Nuk ka pasur ndonjë raportim nga QKMF e tjera, për përfitimin e shërbimeve të mamografisë.

Gratë e komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian kanë qenë të përfshirë edhe në fushatën e Kancerit të Gjirit dhe në fushatën e promovimit të Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, në komunën e Fushë Kosovës.

- **Realizimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë si dhe grupe të tjera të ndjeshme. (2000 vizita)**

QKMF - Fushë Kosovë ; QKMF - Podujevë; QKMF – Mitrovicë; QKMF – Pejë dhe IKSHPK – kanë raportua se janë kryer në Total : 648 vizita për nëna dhe fëmijë prej 0-3 vjet. Këto të dhëna nuk janë të ndara mbi baza etnike.

QKMF Ferizaj ka raportuar se janë realizuar vizita, ku kanë marrë pjesë gjithsej 100 pjesëtar të komunitetit rom dhe 86 pjesëtarë të komunitetit ashkali. Kurse në total janë raportuar 3833 vizita.

QKMF Obiliq ka raportuar, se janë kryer gjithsej 475 vizita në këtë institucion, kurse nga komuniteti rom kanë përfituruar 83 qytetarë.

QKMF Pejë ka raportuar se për përmbushjen e këtij aktiviteti, janë kryer gjithsej 760 vizita, mirëpo në fletëzën e intrvizimit për vizita në shtëpi, nuk ekzistonte ndarja etnike, sipas komuniteteve ku përfshihen edhe komunitetet rom, ashkali por edhe egjiptian

Objektiva specifike 2: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali.

- **Nxitja e familjeve rom dhe ashkali për të ndjekur rregullisht oraret e vaksinimit**

QKMF Gjilan nëpërmjet mbështetjes së organizatës Balkan Sunflower, ka bërë vizita derë me derë për vaksinimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë proces kanë qenë të përfshirë dhjetë (10) fëmijë pjesëtarë të këtyre komuniteteve, për shkak se të tjerët vaksinojnë fëmijët e tyre në sistemin shëndetësor paralel serb.

Sipas të dhënave të IKSHKP, në vitin 2023, përmes fushatës derë më derë, me qëllim të vaksinimit janë përfshirë 1287 familje të komuniteteve rom dhe ashkali. Nga këto familje në këtë proces janë përfshirë 5515 fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali.

Nga QKMF Obiliq është raportuar se kanë se në kuadër të fushatës së vaksinimit kanë përfituar 118 rom, kurse nga QKMF në Pejë është raportuar që kjo shifër për vitin 2023, ka arritur në 154 persona, pjesëtar të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

- **Përfshirja e një përfaqësuesi të komuniteteve rom dhe/ose ashkali në Këshillin e Pacientëve - në komunat relevante**

Sipas të dhënave të raportuara për këtë aktivitet, rezultojnë që QKMF në Lipjan kanë themeluar Këshillin e Pacientëve dhe se në kuadër të këtij këshilli bën pjesë një anëtar nga komunitetet rom dhe ashkali. Njëjtë ka ndodhur edhe në QKMF në Rahovec dhe ndërkohë në proces të themelimit të këtij Këshilli, ku përfshihen edhe anëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali janë edhe dy QKMF të tjera.

- **Ligjërata ndërgjegjësuëse për promovim shëndetësor dhe parandalimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse, ushqyeshmëri, (15 komuna në vit)**

Sipas rezultateve të raportuara nga MSH, IKSHPK ka mbajtur 20 ligjërata, në përmbushjen e këtij aktiviteti. Numri total i pjesëmarrësve ishte 218 (138 burra dhe 80 gra).

Ndërkohë është raportuar që ligjërata për përmbushjen e këtij aktiviteti janë mbajtur nga QKMF-të e Gjilanit, Fushë Kosovës, Podujevës si dhe Ferizajt. Ndërkohë që QKMF në Podujevë ka mbajtur edhe një tryezë diskutimi.

Në anën tjetër, QKMF Ferizaj, raportohet të ketë mbajtur 4 ligjërata për rëndësinë e vaksinimit të fëmijëve, ku kanë marrë pjesë 20 pjesëtarë nga komuniteti rom dhe 60 nga komuniteti ashkali. Po ashtu edhe QKMF Pejë ka organizuar në bashpunim me Syri i Vizionit dhe AQH ku realizua 4 ligjërata.

- **Tryeza ndërgjegjëse për pasojat e martesave dhe lindjeve të hershme, planifikimi familjar dhe IST, menopauza, kanceri në mitër/qafë të mitrës (10 komuna në vit)**

Tryeza të tilla dhe aktivitete që përkojnë me përmbushjen e këtij aktiviteti kanë organizuar QKMF-të në Gjilan, ku janë mbajtur tryeza dhe ligjërata; QKMF në Fushë Kosovë ka mbajtur ligjërata, siç u theksua edhe më sipër; QKMF në Mitrovicë, ka mbajtur gjithsejtë 5 tryeza me 120 pjesëmarrës kurse IKSHKP, është raportuar se ka mbajtur 5 tryeza. Ligjërata dhe tryeza në përmbushjen e këtij aktiviteti ka mbajtur QKMF Ferizaj, ku kanë marrë pjesë gjithsejtë 10 pjesëtar të komunitetit rom dhe 30 pjesëtarë të komunitetit ashkali.

Njëjtë është raportuar se ligjërata ka mbajtur edhe QKMF në Obiliq, ku kanë marrë pjesë 40 pjesëtar të komunitetit rom, në gjithësejt 3 ligjërata dhe tryeza.

- **Organizimi i takimeve koordinuese në mes te MSH, donatorët dhe OJQ që merren me aktivitete shëndetësore. (2 herë në vit)**

Lidhur me përmbushjen e këtij aktiviteti, QKMF Fushë Kosovë ka mbajtur gjithsej 4 takime, të kësaj natyre. MSH po ashtu ka mbajtur takime të rregullta me OJQ dhe donatorët, lidhur me përmbushjen e këtij aktiviteti.

- **Shpërndarja e materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues (6000 fletushka, 1000 postera + përkthimet dhe 500 dhe 100 kopje në gjuhën romë)**

Me qëllim të përmbushjes së këtij aktiviteti, të objektivës specifike 2, MSH ka raportuar se Komisioni Edukimit Shëndetësor në IKSHPK ka bërë shqyrtimin dhe aprovimin e materialeve, ndërsa shpërndarja është bërë nga donatorët dhe kujdesi parësor shëndetësor -të dhëna nga IKSHPK. Në linjë me këtë, QKMF Obiliq ka raportuar se janë shpërndarë 400 copë materiale informuese.

- **Fushata ndërgjegjëse për rëndësinë e imunizimit të rregullt (shpërndarja e fletushkave dhe organizimi i ekipeve mobile)**

Siç u theksua edhe më sipër gjatë vitit 2023 kanë qenë 5515 familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian te vizituara derë me derë për identifikimin e fëmijëve të pa vaksinua. Në linjë me përmbushjen e këtij aktiviteti, QKMF Fushë Kosovë ka raportuar se ka kryer 3 tryeza kanë përfituar 40 persona të komuniteteve rom dhe ashkali. Ndërkaq që MSH ka raportuar që QKMF në Obiliq, ka mbajtur pesë (5) diskutime, ku kanë marrë pjesë 102 rom.

- **Përkthimi i materialeve promovuese për ngritjen e ndërgjegjësimit në gjuhën romë**

MSH nuk ka pasur ndonjë të dhënë konkrete që vërteton se është bërë përkthimi i materiale promovuese, në ngritjen e ndërgjegjësimit në gjuhën romë, në fushën e shëndetësisë. Si rrjedhojë ky aktivitet përgjatë vitit 2023, nuk rezulton të jetë përmbushur.

Objektiva specifike 3: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali.

- **Ofrimi i trajnimit për stafin profesionist shëndetësor për mos diskriminim në ofrimin e shërbimeve mjekësore, (20 komuna) (trajneri, transporti, materiale, ushqim)**

MSH ka mbajtur pesë (5) tryeza diskutimi me profesionistët shëndetësor (infirmier) të nivelit parësor lidhur me prezantimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe e drejta për shëndet e drejtë e njeriut e mbrojtura me Konventat Ndërkombëtare. Tryezat janë mbajtur në Kujdesin Parësor pasi që kontakti i parë i pacientit me mjekun është në nivel të kujdesit parësor shëndetësor.

Po ashtu, këto tryeza janë mbajtur edhe në nivel të QKMF-ve, si: QKMF– Lipjan; QKMF – Rahovec; QKMF – Istog; QKMF–Fushë Kosovë; QKMF–Obiliq. MSH raporton se tryezat kanë përfshirë 80 profesionistë shëndetësor të përgatitjes profesionale: kryeinfirmier dhe infermiere. Në këto tryeza, kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë që vazhdohet me këtë temë prezantimin në të gjitha Komunat që të përfshihet një numër sa me madhe në këto lloj trajnimesh pasi është temë me rëndësi në punën e tyre të përditshme.

Lidhur me numrin e tryezave për përmbushjen e këtij aktiviteti, raportohet se QKMF në Pejë ka mbajtur katër (4) tryeza me pjesëmarrje prej 10 veta kurse QKMF në Obiliq ka mbajtur 6 trajnime, me temën e këtij aktiviteti ku kanë përfituar 70 veta.

- **Organizimi i iniciativave të fushatës vetëdijesuese për të drejtat e pacientit dhe mekanizmave përgjegjës për ankesa të komuniteteve rom dhe ashkali drejtuar punëtorëve shëndetësor dhe pjesëtarëve të komuniteteve**

MSH raporton që janë mbajtur tryeza me komunitetet rom dhe ashkali, ku kanë marrë pjesë qytetarë të këtyre komuniteteve. Temat që kanë dominuar këto tryeza kanë qenë: prezantimi i ligjit për mbrojtje nga diskriminim, e drejta e ankesës dhe e drejta për shëndet si e drejtë e njeriut e mbrojtur me Kushtetutë dhe Konventa Ndërkombëtare.

Lidhur me këto tryeza dhe mbajtjen e tyre, MSH raporton se ato si të tilla janë mbajtur në tri (3) Komuna, respektivisht në QKMF– Lipjan; QKMF –Podujevë; QKMF – Pejë. Tryezat kanë përfshirë 50 qytetare të komunitetit rom ashkali dhe egjiptian: udhëheqës i OJQ –ve , të këtij komuniteti. Po ashtu, QKMF në Pejë në bashkëpunim me PRAK, AQH, dhe Syri vizionit kanë realizuar katër (4) tryeza ku kanë marrë pjesë gjithsej 47 veta, pjesëtarë të komuniteteve rom dhe

ashkali. QKMF në Obiliq ka raportua se ka mbajtur një (1) trajnim te kësaj natyre dhe kanë përfituar 25 persona, nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali.

4.3.1 Rekomandimet për zbatimin e strategjisë në fushën e shëndetësisë

1. Të realizohet një hulumtim më gjithëpërfshirës për kënaqshmërinë në marrjen e shërbimeve shëndetësore.
2. Të evidentohen në evidencat e QKMF-ve, me rastin e vizitave shtëpiake edhe qytetarët mbi baza etnike.
3. Të ndërmerren masa për realizimin e sigurimit shëndetësor, për 95% të pjesëtarëve të komuniteteve rom, sipas përcaktimeve në Deklaratën e Poznanit.
4. Të themelohet këshilli i pacientëve në të gjitha QKMF dhe në kuadër të tij të përfshihen pjesëtar të komuniteteve rom dhe ashkali. Institucionet kompetente inkurajohen të raportojnë për këtë rezultat, me qëllim të përmbushjes së objektivës specifike 2.
5. Të ndërmerren masa dhe të intensifikohet mbajtja e ligjëratave ndërgjësuese, për komunitetet rom dhe ashkali, për ndërgjegjësimin shëndetësor dhe parandalimin e sëmundjeve kronike ngjitëse, deri në 15 komuna në vit.
6. QKMF në të gjitha komunat, duket të mbajnë më shpesh tryeza ndërgjësuese për pasojat e martesave dhe lindjeve të hershme, planifikimi familjar dhe IST, menopauza, kanceri në mitër/qafë të mitrës dhe kjo duhet të arrijë deri në 10 komuna në vit.
7. Institucionet qendrore dhe lokale, në koordinim me donatorët dhe shoqërinë civile, të ndërmarrin hapa konkret për përkthimin e materialeve ndërgjësuese, në gjuhën rome, nga fusha e shëndetësisë.
8. MSH dhe institucionet e tjera relevante, në bashkëpunim me donatorët, me qëllim të mbështetjes së komuniteteve rom dhe ashkali, të mbajnë më shumë trajnime për stafin profesionist shëndetësor, për mos diskriminim dhe trajtim të barabartë të komuniteteve rom dhe ashkali, me qëllim të përmbushjes së objektivës specifike 3.

4.4. ZBATIMI I STRATEGJISË NË FUSHËN E BANIMIT

Fusha e banimit është një çështje e veçantë e raportit për zbatimin e Strategjisë, për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2024-2026. Për realizimin e aktiviteteve në fushën e banimit dhe përmbushjen e Strategjisë dhe Planit të veprimit respektiv, janë paraparë objektiva strategjike dhe ato specifike.

Objektiva strategjike e përcaktuar në Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 është:

1. Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, 109 shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike për komunitetet rom dhe ashkali.

Kurse për përmbushjen e objektives strategjike, në fushën e banimit, në kuadër të strategjisë janë të parapara edhe objektivat specifike si në vijim:

1. Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe përcaktimi i hapave konkret për të përmirësuar sistematikisht gjendjen e banimit për komunitetet rom dhe ashkali.
2. Vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zgjidhjen e problemeve të banimit.
3. Ngritja e komoditetit dhe cilësisë së jetës së komuniteteve rom dhe ashkali përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese si dhe infrastrukturës përcjellëse për qasje më të mirë në shërbime esenciale.
4. Qasja e barabartë dhe përmirësimi i shërbimeve cilësore të banimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërgjegjësimit të stafit publik përgjegjës për programet e banimit.
5. Formalizimi i vendbanimeve joformale të komuniteteve rom dhe ashkali përmes revidimit të planeve ekzistuese urbanistike dhe përfshirjes konkrete në planet e reja urbanistike si dhe ofrimit të alternativave për riorganizimin e vendbanimeve ekzistuese.
6. Qasja e barabartë në shërbime esenciale, përfshirë ujin, kanalizimin, shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, dhe luftimi i segregimit hapësinor si shkak i diskriminimit mjedisor në fushën e banimit.

Përgjatë Vitit 2023, janë raportuar veprime konkrete, nga ana e MMPHI dhe komunave të cilat kanë konsistuar në përmbushjen e objektiveve specifike, në përmbushjen e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024.

Objektiva specifike 1: Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe përcaktimi i hapave konkret për të përmirësuar sistematikisht gjendjen e banimit për komunitetet rom dhe ashkali.

Në Kuadër të kësaj objektive, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) brenda kompetencave të saj, ka ndërmarrë hapa konkret për të krijuar një sistem të drejtë dhe të përbalueshëm të banimit social për të gjithë qytetarët duke përfshirë:

Nënshkrimi i marrëveshjes me CEB, e cila siguron burime të nevojshme për realizimin e projektit. Komponentët e këtij projekti përbëhet nga nën-projekte të caktuara si përmirësimi, shndërrimi dhe ndërtimi i banesave sociale, si dhe renovimi i shtëpive individuale për familjet e varfra.

Në kuadër të kësaj objektive, rëndësi ka edhe inkurajimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së komunave ka një rol kyç dhe për këtë është siguruar grant nga WBIF për Asistencën Teknike për përkrahje të implementimit për Projektin e Banimit Adekuat Social

Sa i përket sigurimit të qëndrueshmërisë dhe përcaktimi konkret për të përmirësuar sistematikisht gjendjen e banimit për komunitetet rom dhe ashkali, rëndësi ka edhe gjendja e programeve tre vjeçare të banimit në Komunat e Kosovës. Sipas statistikave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, 17 Komuna kanë pasur plan tre vjeçar të banimit; 7 Komuna e kanë pasur këtë plan me afat të

skaduar; 3 komuna ka rezultuar që planin e kanë në draft dhe duke e hartuar si dhe 10 komuna nuk kanë hartuar fare këtë plan.

Sipas ligjit për Financimin e programeve të veçanta të banimit, Komunitetet kanë përgjegjësit të hartojnë për periudhën tre (3) vjeçare në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet që janë në Komunë. Për zbatimin e tyre, sipas Ligjit për Financimin e programeve të veçanta të banimit duhet të raportohet në çdo 31 mars të vitit vijues. Megjithatë, sipas të dhënave të MMPHI shumë pak komuna raportojnë për implementimin e projekteve në kuadër të programeve trevjeçare të banimit.

Gjendja e programeve trevjeçare të banimit në komunat e Kosovës 12.06.2023				
nr.	Me afat kohor	Te skaduar	Draft	Nuk e kanë të hartuar
1	Deçan 2022-2025	Hani i Elezit	Viti	Dragash
2	Fushë Kosovë 2022-2024	Kamenicë	Novobërdë	Junik
3	Istog 2022-2026	Malishevë	Suharekë	Klllokot
4	Podujevë 2023-2025	Pejë		Leposaviq
5	Obiliq 2022-2025	Vushtrri		Mamush
6	Mitrovicë e Jugut 2022-2024	Prizren		Mitrovicë e Veriut
7	Klinë 2022-2025	Shtërpçë		Partesh
8	Rahovec 2022-2024			Prishtinë
9	Kaçanik 2022-2024			Zubin Potok
10	Gjakovë 2021-2023			Zveçan
11	Graçanica 2022-2025			
12	Skenderaj 2021- 2023			
13	Ferizaj			
14	Shtime			
15	Gjilan 2023-2025			
16	Lipjan 2023-2025			
17	Glllogoc 2023-2025			
Gjendja e Programeve trevjeçare të banimit në Komunat e Kosovës				
17 Programe trevjeçare të banimit me afat kohor				
7 Programe trevjeçare të banimit të skaduar				
3 Programe trevjeçare të banimit në pritje (draft)				
10 Programe trevjeçare të banimit komuna nuk kanë të hartuar				

Objektiva specifike 2: Vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zgjidhjen e problemeve të banimit

Vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zgjedhjen e problemeve të banimit është një objektive e rëndësishme e Strategjisë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026. MMPHI, ka raportuar që lidhur me këtë objektive specifike ndër të tjera:

Janë mbajtur trajnime për zyrtarët komunal për funksionalizimin e platformës elektronike, data baza e banimit social. Ky trajnim është përkrahur nga RCC.

Po ashtu është bërë hartimi dhe aprovimi i Studimit të Fizibilitetit për Banim Social adekuat, në Republikën e Kosovës. Nga studim fizibiliteti kanë dal këto rekomandime:

- Ka një mungesë të dukshme të efektivitetit dhe koordinimit nga autoritetet kombëtare/lokale, gjë që i lë përfituesit të pa informuar për mundësitë e banimit social dhe pa mbështetjen e duhur.
- Ndërtesat aktuale të Banimit Social janë në gjendje jo të mirë dhe kanë nevojë urgjente për renovime. Monitorimi dhe mirëmbajtja e rregullt pothuajse nuk ekziston, me ndarje të paqartë të përgjegjësi, të stafit dhe buxheteve të alokuara.
- Programet tre (3) vjeçare të banimit nuk përgatiten rregullisht nga komunat dhe nuk raportohen në MMPHI-ja. Secila komunë duhet të caktoj të paktën një zyrtar që do të merret me të gjitha nevojat dhe aplikimet për banim social.
- Ka nevojë për një sistem më të mirë të menaxhimit të të dhënave në nivel lokal për të mbledhur, mirëmbajtur dhe analizuar të dhënat e aplikantëve për banim, dhe për të përmbushur më mirë kërkesat e tyre.
- Nevojitet më shumë financime në këtë sektor, mbështetur nga plane dhe programe të qarta zhvillimi 95% e komunave theksuan financat si pengesën më të madhe për funksionimin apo zhvillim e sektorit të banimit social.

Objektiva specifike 3: Ngritja e komoditetit dhe cilësisë së jetës së komuniteteve rom dhe ashkali përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese si dhe infrastrukturës përcjellëse për qasje më të mirë në shërbime esenciale

MMPHI, ka raportuar që janë ndërmarrë disa veprime që rezultojnë me ngritjen e komoditetit dhe cilësisë së jetës, për komunitetet rom dhe ashkali, në kuptim të përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese.

Nga CEB-Banka është aprovuar kërkesa për kredi me interes të ulët prej 25.0 milion euro për bashkëfinancimin e Projektit të Banimit Adekuat Social. Pas një pune shumë vjeçare me datë 25 janar 2024, është nënshkruar kjo marrëveshje për kredi, e cila ka për qëllim që të përmirësojë

kualitetin e cilësisë së jetës edhe të komuniteteve rom dhe ashkali. Në vitin 2024 pritet të bëhet ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Siç u tha edhe më sipër, nga WBIF është fituar Grantin për Asistencë Teknike prej 2.08 milion Euro. Realizimi i bashkëpunimit me Asistenca Teknike 11 (IPF 11) për Programin Adekuat për Banim Social. Po ashtu edhe ky projekt pritet të ndikojë në përmirësimin e kualitetit të jetës së komuniteteve rom dhe ashkali.

Në kuptim të përmbushjes së kësaj objektivë, rindërtimi dhe renovimi i shtëpive në Veri të Kosovës, për familjet që shtëpitë e tyre që janë dëmtuar në periudhën kohore 1998/99 dhe realizimi i rindërtimit dhe renovimit. Gjithashtu qiratë për familjet e riatdhesuara përbën një të arritur, në vitin 2023, në kuptim të përmbushjes së objektivave, të fushës së banimit, përkritazi me strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024.

Një çështje e rëndësishme në këtë aspekt është hartimi dhe aprovimi i Studimit të Fizibilitetit për Banim të Përballeshëm në Kosovë.

Objektiva Specifike 4: Qasja e barabartë dhe përmirësimi i shërbimeve cilësore të banimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali, përmes ndërgjegjësimit të stafit publik përgjegjës për programet e banimit

Qasja e barabartë dhe përmirësimi i shërbimeve cilësore të banimit është shumë e rëndësishme, përmes ndërgjegjësimit të stafit publik përgjegjës për programet e banimit.

Megjithatë, nga raportimet e MMPHI, në kuptim të kësaj objektivë është vërejtur një neglizhencë e komunave në raportimin e përmbushjes së programeve të veçanta tre (3) vjeçare të banimit.

Kjo neglizhencë e raportimit nuk mund të ofrojë një perspektivë të plotë për qasje të barabartë në shërbimet në fushën e banimit, duke pasur parasysh që një numër i çështjeve janë kompetenca komunale.

Edhe përgjatë vitit 2023, përveç të arriturave të theksuara më sipër, nuk ka pasur ndonjë përparim të dukshëm në lidhje me çështjen e komunitetit rom dhe ashkali që janë në vendbanime jo formale dhe që mund të legalizohen. Kjo është edhe një prioritet i rëndësishëm i Deklaratës së Poznanit. Përgjithësisht në këtë aspekt ka pasur hapa të ngadalshëm të cilat duhet të merren parasysh në vazhdimësi, nga ana e institucioneve qendrore, respektivisht MMPHI dhe komunave të Kosovës.

4.4.1 Rekomandimet e zbatimit të strategjisë në fushën e banimit

1. MMPHI, duhet të ndërmarrë veprime konkrete brenda kompetencave të saj, për të përmirësuar gjendjen e banimit të komuniteteve rom dhe ashkali.
2. Komunitet e Republikës së Kosovës, duhet të hartojnë programet tre (3) vjeçare të banimit, për të për shkak se në qershor 2023, ka rezultuar që 20 Komuna nuk kanë pasur fare këtë plan.
3. Të trajtohen me prioritet rekomandimet që kanë dalë nga Studimi i Fizibilitetit për Banim Social adekuat, në Republikën e Kosovës, sipas të cilit ka raportuar MMPHI.
4. Rekomandohet që MMPHI si institucion qendror por edhe komunitet e Kosovës, të marrin me prioritet përmbushjen e obligimeve nga Deklarata e Poznanit, me qëllim që të bëhet legalizimi i vendbanimeve të komuniteteve rom dhe ashkali.
5. Rekomandohet të ketë një koordinim më të qëndrueshëm në mes të nivelit qendror dhe lokal, me qëllim të zbatimit të projekteve në fushën e banimit.
6. Të bëhet përgatitja e manualit për banim adekuat social, për projektin e banimit adekuat social.
7. Të bëhet themelimi për njësitin menaxhues të projekti për banim adekuat social si dhe njësitin implementues në nivel lokal.

4.5. ZBATIMI I STRATEGJISË NË LUFTIMIN E DISKRIMINIMIT

Me qëllim të zbatimit të strategjisë, për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, një rëndësi të veçantë e ka edhe luftimi i diskriminimit, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Për përmbushjen së objektivave strategjike dhe atyre specifike, nga institucionet kompetente, sidomos nga ZQM/ZKM janë ndërmarrë veprime të theksuara, me qëllim të luftimit të diskriminimit.

Objektiva strategjike, e përcaktuar në strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024 është:

1. Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykimeve, stereotipeve, dhe bullizmit.

Kurse objektivat specifike, që konsistojnë në plotësimin e objektivave strategjike, përkitazi me luftimin e diskriminimit, për komunitetet rom dhe ashkali janë:

1. Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve;

2. Ulja e dukurisë së racizmit dhe diskriminimit dhe rritja e cilësisë së jetës për komunitetet rom dhe ashkali në mënyrë sistematike përmes zhvillimit të propozimit legjislativ për barazi, pjesëmarrje, përfshirje dhe luftimit të racizmit dhe diskriminimit;
3. Rritja e llogaridhënies dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë dhe mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës dhe dhunës së urrejtjes dhe bullizmit;
4. Rritja e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali përmes vetëdijesimit dhe ndërgjegjësimi të publikut dhe zyrtarëve publik për racizëm dhe antidiskriminim ndaj komuniteteve rom dhe ashkali si dhe promovimit të historisë dhe kulturave të komuniteteve rom dhe ashkali;
5. Mbështetja dhe avancimi i punës së Grupit Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve rom, ashkali dhe Egjiptian, të themeluar nga Qeveria, për të adresuar ankesat nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për diskriminim ndaj tyre, si dhe për të realizuar aktivitetet për vetëdijesimin e publikut për parandalimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Nuk ka asnjë dilemë që njëri ndër projektet më të suksesshme, në luftimin e diskriminimit me qëllim të mbrojtjes së komuniteteve rom dhe ashkali, në kuptim edhe të përmbushjes së objektivave strategjike dhe specifike, ka qenë puna e Grupit Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Andaj, edhe përmbushja dhe zbatimi i kësaj strategjie, në kuptim të luftimit të diskriminimit, duhet ndërlikur me punën e grupit teknik dhe të Platformës Kombëtare.

4.6. Grupi punues Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si mekanizëm për luftimin e diskriminimit, në kuptim të përmbushjes së objektivave të strategjisë

Grupi teknik për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, u krijua me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, si mekanizëm institucional, për të adresuar rastet dhe për të luftuar diskriminimin e këtyre komuniteteve, mbi të gjitha bazat që i mundëson legjislacioni i zbatueshëm. Ndër të tjera, ky grup, mori si obligim që të adresojë të gjitha ankesat për të mbrojtur nga diskriminimi, pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Përveçse, në Kushtetutë dhe LMD, grupi teknik ka për qëllim që të zbatojë Deklaratën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin Romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Grupi Punues teknik për mbrojtjen nga diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është duke funksionuar në pajtim me Vendimin e Kryeministrit me datë 11.09.2020- me nr. 138/2020 për Themelimin e Grupit teknik punues për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Qëllimi i krijimit të Grupit teknik të punës ishte zbatimi i përgjegjësive që dalin nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Fushëveprimi kryesor i grupit teknik është mbrojtja nga diskriminimi komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga diskriminimi. Në përbërjen e grupit teknik përfshihen përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, si përfaqësuesit e ministrive përkatëse; dy (2) përfaqësues nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit; Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK); Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKPK); Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP); Drejtori i VoRAE etj. Më vonë, marrë parasysh nevojat, përbërja e grupit teknik është ndryshuar dhe pjesë e saj janë bërë edhe partnerët e tjerë, përfshirë edhe TDhK. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit është kryesuese e grupit teknik dhe udhëheq sekretariatit e këtij grupi.

Me qëllim të zbatimit të mandatit të tij, Grupi Teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit si sekretariat i këtij grupi, ka krijuar Platformën Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo platformë është duke shërbyer si mekanizëm alternativ për luftimin e diskriminimit për këto komunitete dhe si mekanizëm që zbaton mandatin e Grupit Teknik, sipas vendimit të Kryeministrit për krijimin e këtij Grupi.

Përgjatë vitit 2021, 2022, 2023, me qëllim të adresimit të çështjeve për mbrojtjen nga diskriminimi ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, grupi teknik ka mbajtur 8 (tetë) takime.

Në takimet e grupit teknik përveç anëtarëve, sipas vendimit për themelimin, ftohen edhe organizata të tjera të shoqërisë civile, përveç VoRAE që është pjesë e vendimit. Pjesë e takimeve të rregullta të Grupit Teknik janë TDhK dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Me qëllim të mirë funksionimit, siç u tha më sipër punën e Grupit Teknik e organizon Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe ky grup, përfshirë edhe platforma, mbështeten nga staf profesional (ekspert dhe administrator) i cili mbështetet nga TDhK. Eksperti ligjor në kuadër të grupit teknik, analizon dhe përcjell rastet që raportohen në platformë si dhe harton shkresat për adresimin e këtyre rasteve tek institucionet kompetente. Po ashtu eksperti juridik harton edhe rekomandime konkrete për Grupin Teknik.

Nga rastet që janë trajtuar nga ekipi profesional që mbështetin Grupin Teknik dhe Platformën, 2 prej tyre janë raportuar në Grupin Teknik, kurse 5 prej tyre në Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, gjatë vitit 2019,

përderisa Grupi Teknik nuk ka qenë akoma i themeluar. Që nga lansimi i Platformës, 34 raste të reja janë paraqitur direkt në platformë. Kjo tregon që Platforma ka pasur një efekt të rëndësishëm në aktivizimin e Grupit Teknik dhe plotësimin e përmbushjes së mandatit të tij. Pas lansimit të platformës edhe rastet e raportuara në vitin 2020 në Grupin Teknik dhe në vitin 2019 në Zyren për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, janë regjistruar dhe trajtuar nga platforma dhe kjo ka rritur numrin total të rasteve në platformë për 41, deri me 1 dhjetor 2023.

Grupi Punues teknik edhe gjatë vitit 2023 ka funksionuar në mënyrë të mirëfillte, ku janë organizuar dy takime me 07.02.2023 dhe me 11.07.2023. Gjatë takimeve është vlerësuar puna e Platformës Kombëtare për Raportimin e Rasteve të Diskriminimit ndaj Komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian si rastet e raportuara në Platformë dhe funksionimi i Platformës, rritja e efikasitetit të Platformës për përdorues të saj.

Rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në vazhdimësi është duke u pranuar dhe trajtuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe për këtë janë duke kontaktuar personat që kanë dorëzuar rastet dhe institucionet përgjegjëse të shqyrtojnë dhe vlerësojnë ankesat e qytetarëve. Për mirë funksionimit të platformës dhe për zgjedhjen e rasteve të raportuara në Platformë, Grupi teknik në takimet e saj ka diskutuar dhe koordinuar procesin mes institucioneve përgjegjës për trajtimin e zgjedhjen e rasteve, ku rastet janë adresuar të institucionet përgjegjës qoftë përmes shkresave apo qoftë edhe duke kontaktuar dhe takuar me zyrtaret përkatëse.

4.6.1. Platforma Kombëtare për raportimin e rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si mekanizëm i grupit teknik, me qëllim të luftimit të diskriminimit përkitazi me përmbushjen e strategjisë dhe përcaktimeve të deklaratës së Poznanit

Shqyrtimi e ankesave të qytetarëve në Platformën Kombëtare për raportimin e rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për këtë qëllim në vazhdimësi kontaktohen palët ankues në Platformë ku i ndihmohet me këshilla dhe me hartimin e shkresave deri në dorëzimi i saj në institucionet përgjegjës për të shqyrtuar dhe vlerësuar ankesat e qytetarëve. Puna rreth kësaj Platforme ka nisur prej datës 1 maj, 2022, përderisa lansimi zyrtar i saj është bërë me 22 qershor 2022.

Rastet e raportuara në platformë që nga fillimi i punës së saj, janë trajtuar sipas një metodologjie të punës që ndjek logjikën e institucioneve kompetente sipas LMD dhe institucioneve që përcaktohen me ligjet e veçanta. Të gjitha rastet tek institucionet janë punuar nga ekipi profesional i platformës dhe janë adresuar nga grupit teknik, që kryesohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim / Zyra e Kryeministrit.

Me rastin e raportimit, platforma sipas rregullave të vendosura nga grupi teknik ka analizuar rastin dhe për secilin rast ka përgatitur një raport analitik, duke dhënë rekomandime, përfshirë edhe

institucionet në të cilat duhet të adresohet rasti. Ekipi profesional i platformës dhe grupi teknik, fillimisht të gjitha rastet i ka adresuar tek institucionet në të cilat ka ndodhur diskriminimi, me qëllim të parandalimit të tyre si dhe tek institucionet tjera kompetente për luftimin e diskriminimit sipas LMD.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër institucional, në disa raste ka pasur një efikasitet të kënaqshëm në trajtimin e rasteve nga disa prej institucioneve. Një shembull i tillë mund të përmendet Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e cila në mënyrë profesionale ka trajtuar rastet e adresuara nga platforma. Po ashtu, në rastin e diskriminimit të fëmijëve në një shkollë në komunën e Prizrenit, platforma ka pranuar përgjigje të shpejtë, brenda 24 orëve nga Drejtoria Komunale e Arsimit, për trajtimin rastit dhe parandalimit të diskriminimit.

Gjithashtu edhe në rastet e diskriminimit që kanë ndodhur në Komunën e Fushë Kosovës, ndonëse ekipi i platformës ka ndërmarrë veprime të menjëhershme, megjithatë është vërejtur një vonesë në kthimin e përgjigjeve nga Komuna e Fushë Kosovës si dhe përgjigjet e pranuar nuk kanë qenë adekuate dhe nuk kanë sqaruar çështjet e ngritura nga ekipi i platformës.

Përsa i takon rasteve të raportuara tek Avokati i Popullit, edhe pse kërkesat e pranuar për trajtim, që nga muaj prill 2023, ekipi i platformës dhe grupi teknik nuk ka marrë përgjigje në lidhje me këto raste edhe pse ka kaluar afati prej 6 muajve për hetimin e rastit, siç përcaktohet në rregulloren e punës së Avokatit të Popullit.

Ndërkaq është evidente procedura e trajtimit të rasteve nga Gjykata, ndonëse është obligim ligjor sipas LMD, neni 16.9 të trajtohen me prioritet, nuk është bërë një gjë e tillë.

Inspektorati i Arsimit, në trajtimin të diskriminimit që ka ndodhur në Komunën e Fushë Kosovës, ka kthyer përgjigje brenda ditës, duke njoftuar platformën për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me rastin si dhe ka dalë me raport dhe rekomandime në lidhje me rastin e raportuar. Në bazë të statusit të rasteve, në kuptimin e trajtimit të tyre, përveç rasteve të mbyllura dhe të përfunduara nga platforma ose të përfunduara me një vendim të Institucioneve, ka edhe raste janë raportuara anonime ose janë në procedurë të trajtimit nga institucionet.

Tabela e mëposhtme pasqyron gjendjen e bashkëpunimit ndërinstitutional në menaxhimin e rasteve të raportuara në platformë për 17 muaj të punës së saj, respektivisht deri me 15 nëntor 2023.

Rastet e trajtuara sipas institucionit dhe statusit procedural të trajtimit të rastit në periudhën Qershor 2022-Nëntor 2023

Institucioni që është duke e trajtuar rastin	Numri	Procedura/statusi e rastit që është duke u trajtuar
--	-------	---

Avokati i Popullit	1	I trajtuar me raport exofficio 18.11.2023 ¹
Avokati i Popullit	1	Nuk ka raport ose rekomandim
Avokati i Popullit dhe Inspektorati i Arsimit	1	Nuk ka një vendim nga inspektorati ose Avokati i Popullit.
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	Nuk ka akoma vendim të shkallës së parë.
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	Është vërtetuar diskriminimi indirekt me aktgjykim të gjykatës.
Inspektorati i Arsimit dhe Avokati i Popullit	1	Duke u trajtuar dhe nuk ka ende vendim përfundimtar.
Komuna e Fushë Kosovës	1	Në pritje të vendimit/përgjigjes.
Komuna Prizren/Drejtoria e Arsimit	1	Rasti i përfunduar/parandalim i diskriminimit.
Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia e regjistrimit civil	4	Të përfunduara/nuk ka diskriminim.
Policia e Kosovës/Prishtinë	2	Në procedurë të hetimit.
Prokurori i shtetit	1	Në trajtim të kallëzimit penal.
Universiteti i Gjakovës	1	I trajtuar nga Universiteti.
Në proces të trajtimit nga platforma.	2	Duke mbledhur dhe analizuar informacionit dhe faktet.
Raste të regjistruara në platformë	21	Rastet vetëm janë regjistruar dhe nuk kanë rezultuar si diskriminuese, për shkak të mungesës së informacionit të raportuar në platformë, sipas sqarimeve të dhëna në raport.
39 RASTE		

4.7. Rekomandimet për në fushën e luftimit të diskriminimit

1. Nevoja për koordinim më të theksuar në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve për nxitjen e raportimit të diskriminimit.
2. Rekomandohet që të ndërmerren fushata për promovimin më të theksuar të Grupit Teknik për të Drejtat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të përmbushjes së zotimeve që dalin nga Deklarata e Poznanit.

¹ Rasti i ngjashëm është trajtuar edhe nga Platforma dhe i njëjti është paraqitur tek Avokati i Popullit.

3. Të ndërmerren veprime avokuese, të cilët shërbejnë për promovimin sa më të gjerë të Platformës kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
4. Rekomandohet që institucionet kompetente të ndërmarrin më shumë fushata avokuese, për vetëdijësimin e komuniteteve rom dhe ashkali në raportimin e rasteve të diskriminimit.
5. Rekomandohet ndërmarrja e më shumë veprimeve konkrete për luftimin e gjuhës së urrejtjes, për komunitetet rom dhe ashkali.

5. AKTIVITETET E NDËRMARRA NGA ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË / ZYRA E KRYEMINISTRIT PËR AVANCIMIN E TE DREJTAVE TE KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NDËRLIDHUR ME PËRMNBUSHJEN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË-SHKURT-PRILL 2023

Më aprovimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe Plani i veprimi të saj 2022-2024 më 20.07.2022 Qeverisë së Republikës së Kosovës paraqet një vazhdimësi të politikave për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve. Kjo Strategji synon të plotësojë hendekun e komuniteteve Rom dhe Ashkali, që përfshinë por nuk kufizohet në fushat: arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, banimit dhe diskriminimit.

Monitorimi i parë për Strategjisë dhe Planit të veprimit është bere përmes hartimit të Raportit vjetor për zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit të saj për vitin 2022, i cili është publikuar në shkurt 2023.

5.2. Organizimi i takimit sektorial më pikat e kontakteve në Ministri dhe më shoqërinë civile që punojnë dhe përkrahin komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Në takimin sektorial i organizuar me institucionet e Kosovës dhe me shoqërinë civile të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ose që punojnë me këto komunitete është bërë prezantimi i Raportit për vitin 2022 për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i veprimit 2022-2024 e hartuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. Takimi ka shërbyer edhe për diskutimin e gjendjes aktuale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në 5 sektorë që janë përfshirë në Strategjia dhe Plani i veprimit. Takimi është organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve projekti KOSINT me 13.04.2023.

Në takim kanë qenë prezent Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Agjencinë për Punësim), Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria Administrimit Pushtetit Lokal, Agjencia e Statistikave, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Barazi Gjinore, Policia e Kosovës si dhe shoqëria civile që punojnë dhe përkrahin komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

5.3. Ekipi ndërinstytucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës

Ekipi ndërinstytucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës e themeluar me Vendim të Qeverisë me Nr. 6/81 me 01.06.2022 ka vazhduar funksionimin e saj edhe në 2023 në bazë Rregullave të punës së ekipit ndërinstytucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës dhe Planin e punës të saj me qëllim për të nxit dhe promovuar punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe për arritjen e kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, siç përcaktohet në Kushtetutë, në Ligjin nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe në legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës.

Është më së e nevojshme të theksohet po ashtu që krijimi i këtij mekanizmi ishte edhe si kërkesë e Deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian (5 korrik 2019), e njohur si Deklarata e Poznanit.

Në takimet e Ekipit ndërinstytucional me Shërbimit Korrektues dhe 6 institucionet tjera siç janë policia, shërbimi provues, zjarrfikësit, menaxhimin e emergjencave dhe dogana që janë pjesë e Akademisë së Sigurisë Publike në Vushtrri kanë shprehur interesim të madh për të rritur numrin e të punësuarve dhe për të nxit punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Si rezultat mund të paraqitet aktivitetet e Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Policia e Kosovës ka zhvilluar aktivitete dhe fushat për promovimin dhe punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, kështu që në gjenerata e 58-të të Policisë së Kosovës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë të punësuar 9 persona; Rom - 2 gra, Ashkali - 3 burra, Egjiptian, 1 femër dhe 3 meshkuj.

Ministria Mbrojtjes ka organizuar Open Day në 7 kazerma të tyre me 27 nëntor (Dita e FSK-se). Open Day ishte i hapur për të gjithë, por do të punojmë për të siguruar një pjesëmarrje sa më shumë të komuniteteve nga mosha 16 vjeç.

Platforma superpuna është lansuar nga Qeveria e Kosovës që mbështetë sektorin privat në krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë e moshës 18-25 vjeç. Subvencioni i Qeverisë do të jetë në nivelin 264 euro/muaj, për 6 muaj me radhë, ndërsa punëdhënësi mund të shtojë edhe mbi këtë shumë. Ekipi i Punës ka kontribuar për promovimin sa më shumë këtë platformë që të nxisë të

rinjtë e moshës 18-25 vjeç nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që të aplikojnë për pozitat e lira në kuadër të platformës: <https://superpuna.rks-gov.net>

Kjo nismë e qeverisë do të kontribuojë në punësimin e të rinjve të komuniteteve, rom, ashkali dhe egjiptian, dhe sidomos në sektorin privat sikur është cekur më lartë.

Aktivitetet tjera të Ekipit ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës janë si ne vijim:

Konferenca “inkurajimi dhe promovimi i punësimit në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian” në nivel lokal; Punësimi është një çështje thelbësore për përmirësimin e situatës socio-ekonomike, ku prek çdo sferë të jetës. Prandaj **nxitja dhe promovimi i politikave të punësimit ne nivel lokal është kyçe për te gjetur një zbatim mirëfilltë te këtyre politikave në mbarë Kosovën.** Prandaj, konferenca e organizuar me 24 maj 2023 kishte për qëllim prezantimin e politikave të ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali dhe nxitjen dhe promovimin e punësimit në nivel lokal duke shkëmbyer praktikat më të mira të komunave për punësimin e komuniteteve romë dhe ashkali. Konferenca është organizuar në bashkëpunim Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) me Programin ROMACTED II për Promovimin e Qeverisjes së Mirë dhe Fuqizimin e Romëve në Nivel Lokal, një program i përbashkët ndërmjet Bashkimit Evropian (DG NEAR) dhe Këshillit Evropës.

Konferenca-Hartimi dhe prezantimi i Politikave Rekomanduese për avancimin dhe rritjen e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit; Në konferencë janë prezantuar “Politikat Rekomanduese për avancimin dhe rritjen e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit” me të gjeturat dhe rekomandimet për punësimin e të diplomuarve nga radhët e këtyre komuniteteve në sektorin e arsimit dhe konferenca ka bashkuar përfaqësues nga Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës dhe institucionet përkrahëse në nivel qendror dhe në nivel lokal si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Konferenca është organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me rrjetin KRAEEYN (Rrjeti kosovar për fëmijërinë e hershme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian), i cili vepron në kuadër të Qendrës për Arsim e Kosovës (KEC) dhe përkrahet nga REYN (Roma, Early Years Network) dhe ISSA (Shoqata ndërkombëtare “Hap pas Hapi”) më 01 mars 2023.

Punëtorja për punësimin e të diplomuarve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit; Punëtorja për punësimin e të diplomuarve nga radhët e

komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit është organizuar me projektin KRAEEYN / Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në mars 2023.

Si rezultat i punëtorisë ZQM/ZKM është takuar me përfaqësues e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ku është diskutuar hapja e një rubrike për arsimin universitar të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin elektronik i të dhënave SMIAL, e cila mund të shërbejë nxjerrjen e statistikave të studenteve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Organizimi e një konference me temën nxitja dhe promovimi i punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivel lokal ; ZQM/ZKM në bashkëpunim me ROMACTED projekt i Këshillit Evropës ka organizuar konferencën me temën “Nxitja dhe promovimi i punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian,” në maj 2024. Gjatë konferencës janë prezantuar politikat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali dhe nxitja dhe promovimi i punësimit në nivel lokal duke ndarë praktikën më të mirë të komunave për punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

5.4. Grupi Teknik i Punës për Koordinimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Institucionet e Kosovës vazhdojnë me vëmendje të veçantë të sigurojnë të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e saj pa dallime përmes kushtetutës dhe kornizës ligjore të Kosovës dhe përmes zbatimit të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Bazuar në kërkesën e dërguar nga Këshilli i Evropës për komentet përfundimtare për Opinionin të ciklit të 5-të, komentet përfundimtare i janë dërguar UNMIK-ut më 16.05.2023 pasi janë konsultuar të gjitha institucionet e Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka vlerësuar ndarjen e draft Opinionit të ciklit të 5-të të Komitetit Këshillëdhënës të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe përfshirjen e komenteve të institucioneve të Kosovës në draft-Opinion të ciklit të 5-të nga Komiteti Këshillëdhënës, të cilët janë përgatit me përkushtim dhe rëndësi të madhe nga institucionet e Kosovës. Është më rëndësi të theksohet që për herë të parë draft opinionin është ndarë me qeverinë e Kosovës për komente nga Komiteti Këshillëdhënës të Këshillit të Evropës.

Grupit Teknik të Punës për Koordinimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është takuar më 16.05.2023 me qëllim të diskutimit të Opinionit të 5-të përfundimtar për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nga Këshilli i Evropës dhe aktivitetet që synohen të ndërmerren për zbatimin e këtyre rekomandimeve në vitin 2023.

5.5. Krijimi i mekanizmave në nivel komuna/Komitetet Komunal Veprues, me qëllim të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit

Për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024 në nivel komunal janë themeluar Komitetet Komunal Veprues nga komunat me shkresë të drejtuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit përmes Ministrisë Administrimit Pushtetit Lokal me 16.01.2023. Të gjitha komunat të cilët kanë një popullsi më të madhe të komuniteteve rom dhe ashkali ju kanë përgjigjur shkresës duke themeluar Komitetet Komunal Veprues, gjithsej 20 komuna.

Komitetet Komunal Veprues janë krijuar në komunat; 1.Rahoveci, 2. Prishtina, 3. Podujeva, 4. Novobërda, 5. Ferizaji, 6. Lipjani, 7. Kamenica, 8. Vushtrri, 9. Gjakova, 10. Istogu, 11. Obiliqi, 12. Prizreni, 13. Deçani, 14. Klina, 15. Peja, 16. Fushë Kosova, 17. Graçanica, 18. Shtime, 19. Suhareka, 20. Gjilan.

Komitetet Komunal Veprues janë krijuar për të arritur qëllimin e zbatimit, monitorimit, vlerësimit efektiv në nivel komunal të strategjisë, pasi që strategjia parasheh një sërë masash që do të zbatohen në të gjitha komunat me një popullsi më të madhe të komuniteteve rom dhe ashkali.

Zbatimi i Objektivave Strategjike të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024 është një prej elementeve kryesore, siç është monitorimi dhe raportimi adekuat për zbatimin në nivel komunal dhe koordinimin vertikal midis Qeverisë dhe institucioneve të nivelit komunal.

Siç u tha, kjo Strategji dhe Plani i Veprimit parashikon një sërë aktiviteteve që do të zbatohen në nivel komunal drejtpërdrejtë nga ministrinë e linjës në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me udhëheqjen komunale.

Komitetet Komunal Veprues, si mekanizma për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 kanë në përgjegjësi hartimin e Planeve Veprimit Lokal, për të arritur qëllimin e zbatimit, monitorimit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit. Përkritazi me hartimin e planit të veprimit lokal, për vitin 2023, statistikën paraqiten si në vijim:

Plani veprimit Lokal që është aprovuar janë 4 Komuna:

1. Rahoveci,
2. Prishtina,
3. Podujeva,
4. Novobërda.

Plani veprimit Lokal në draft që ende nuk është aprovuar janë 8 Komuna:

1. Ferizaji,
2. Lipjani,

3. Kamenica,
4. Vushtrri,
5. Gjakova,
6. Istogu,
7. Obiliqi,
8. Prizreni,
9. Gjilan

Komunat që nuk e kanë hartuar janë gjithsej 10:

1. Mitrovica e Jugut,
2. Mitrovica e Veriut,
3. Leposaviq,
4. Deçani,
5. Klina,
6. Peja,
7. Fushe Kosova,
8. Graçanica,
9. Shtime,
10. Suhareka.

Një dimension i rëndësishëm për zbatimin e planeve të veprimit lokal është buxhetimi i tyre. Komunat që kanë aprovuar Planin e veprimit Lokal kanë ndarë buxhet për zbatimin e saj si në vijim:

- Novobërda 47.670 Euro
- Prishtina Nga 202.809.20 Euro 188.09.20 nga buxheti i komunës
- Rahovec 81.620 Euro

Komunat që kanë hartuar draft Planin e veprimit Lokal dhe që ende nuk e kanë aprovuar kanë parashikuar buxhet si në vijim:

- Vushtrri 43.634.40 Euro
- Gjakovë 965.900.00 Euro
- Lipjan Nga 51.500 euro 34.300 nga buxheti i komunës.

	Komuna	KKV	Data e krijuar	PVL Apruvar /Statusi	PVL Periudha	PVL Buxhet
1.	Ferizaj	Po	30.01.23	Drafti nuk është aprovuar	2023-2026	Jo
2.	Gjilan	Po	22.02.23	Drafti nuk është aprovuar	2023-2026	Jo
3.	Kamenicë	Po	24.02.23	Drafti nuk është aprovuar	2024-2026	Jo
4.	Novobërdë	Po	23.02.23	Aprovuar	2023-2026	€47,670
5.	Mitrovicë e Jugut	Jo	NA	Jo		Jo
6.	Mitrovica e Veriut	Jo	NA	Jo		Jo
7.	Leposaviq	Jo	NA	Jo		Jo
8.	Podujevë	Po	28.02.23	Aprovuar	2023-2026	0
9.	Vushtrri	Po	08.02.23	Drafti nuk është aprovuar	2024-2026	Buxheti i parashikuar €43,634.40
10.	Deçan	Po	16.02.23	Jo		Jo
11.	Gjakovë	Po	01.03.23	Drafti nuk është aprovuar	2024-2026	Buxheti i parashikuar €965,900.00
12.	Istog	Po	20.02.23	Drafti nuk është aprovuar	2024-2027	Jo
13.	Klinë	Po	13.02.23	Jo		Jo
14.	Pejë	Po	25.01.23	Jo		Jo
15.	Fushë Kosovë	Po	27.09.23	Jo		Jo
16.	Graçanicë	Po	08.06.23	Jo		Jo
17.	Lipjan	Po	16.02.23	Drafti nuk është aprovuar	2024-2026	Nga €51,500, €34,300 nga buxheti i komunës
18.	Obiliq	Po	19.01.23	Drafti nuk është aprovuar		NA

19.	Prishtinë	Po	30.03.23	Aprovuar	2023-2026	Nga €202,809.20, €188,059.20 nga buxheti i komunës
20.	Shtime	Po	20.02.23	Jo		Jo
21.	Prizren	Po	08.02.23	Drafti nuk është aprovuar		Jo
22.	Rahovec	Po	23.01.23	Aprovuar	2023-2025	€81,620
23.	Suharekë	Po	26.01.23	Jo		Jo

Tabela: Komiteti komunal i veprimit (KKV) dhe hartimi dhe aprovimi i Planeve e veprimit lokal -Shkurt 2024

9.4.1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komitetit Komunal të Veprimit

Në përkrahje të OSBE-së ZQM/ZKM ka zhvilluar trajnimet në 5 regjione të Kosovës. Trajnimi ka pasur për qëllim ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të nivelit lokal për monitorimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe Planit të veprimit të saj 2023-2026. Gjatë trajnimit janë prezantuar dhe tabelat e monitorimit e dizajnuar nga ZQM/ZKM dhe praktikat për te përdorur ato.

Gjithsej, 8 ngjarje komunale që mbulojnë 21 komuna me 160 pjesëmarrës (nga të cilat 47 gra) dhe (1) ngjarje e nivelit qendror duke mbledhur 14 pjesëmarrës (11 prej tyre gra). Grumbullimi i të dhënave është një segment kyç për raportim, prandaj trajnimi është fokusuar edhe në mënyrat e grumbullimit të dhënave.

Trajnimi i është dedikuar anëtarëve të Komiteteve Komunal Veprues për koordinimin e zbatimit të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Planin e veprimit të saj për vitet 2022-2024.

Trajnimet e realizuara janë si në vijim:

- Regjioni i Gjilanit (Kamenicë, Gjilan , Novobërdë) 6 Mars 2023 .
- Regjioni i Mitrovicës (Vushtrri, Podujevë, Mitrovicë dhe Skenderaj) 7 Mars 2023.
- Regjioni i Ferizaj (Ferizaj, Shtime) 10 Mars 2023.
- Regjioni i Istogut (Istog, Klinë) 14 Mars 2023.
- Regjioni Peja (Pejë, Deçan, Gjakovë) 15 Mars 2023.
- Regjionin e Prishtinës (Obiliq , Lipjan) 02 Maj 2023.
- Regjionin e Prishtinës (Graçanicë, Prishtinë, Fushë Kosovë) 8 Maj 2023.
- Trajnimi i nivelit qendror 12 maj 2023.

10.HAPJA E MINIBIBLIOTEKËS NË GJUHËN ROME

Hapja e minibibliotekës në gjuhën rome u bë nga kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti në ambientet e ZQM/ZKM i shoqëruar nga deputetët e komunitetit rom, gjithashtu nga zëvendësministrja Emilia Rexhepi, ministrja Arbërie Nagavci dhe zyrtarë të lartë dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga komunitetet rome. Hapja e Bibliotekës në gjuhën rome u bë më 05.04.2023 me qëllim të shënimit të ditës rome, në shenjë promovimi dhe respekti për traditën dhe kulturën rome, të cilat kanë rëndësi dhe peshë të veçantë në shoqërinë e Kosovës. Minibiblioteka do të bëhet një simbol për të rinjtë e komunitetit romë, për ndriçimin e rrugës së tyre drejt një të ardhmeje më të mirë.

Gjithashtu, ky aktivitet shënon një hap me rëndësi, në përmbushjen e frymës dhe objektivave strategjike dhe specifike të strategjisë, për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024.

11.SAMITI I BALLKANIT PERËNDIMOR KUNDËR DISKRIMINIMIT RACOR

Samiti i Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor, është mbajtur me datë 1-2 nëntor 2023. Ceremonia e hapjes ishte zhvilluar 1 nëntor 2023 dhe ku ka shënuar fillimin e kësaj ngjarje të rëndësishme. Hapja është bere nga Presidentja e Kosovës Zn. Vjosa Osmani dhe Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti. Pas kësaj, sesionet vijuese janë zhvilluar me 2 nëntor 2023, me fjalimin e Kryeministrit Albin Kurti ka filluar dita e dytë e Samitit të Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor. Kryeministri Kurti e ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për ta vazhduar luftën ndaj diskriminimit racor.

Nën sloganin “Unitet në Diversitet”, objektivat e Samitit janë përfshirë:

- Rritja e ndërgjegjësimit për efektet negative të diskriminimit racor dhe ndikimin e tij në shoqëri.
- Identifikimi dhe adresimi i shkaqeve kryesore të diskriminimit racor.
- Diskutimi i strategjive efektive për të luftuar diskriminimin racor.
- Sigurimi i një platforme për shkëmbimin e praktikave dhe përvojave më të mira.
- Krijimi i një hapësire për dialog dhe bashkëpunim ndërmjet pjesëmarrësve.
- Forcimi i rrjetit të individëve dhe organizatave të angazhuara për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit racor.

Samiti është organizuar nën udhëheqjen e Zyrës së Kryeministrit - Republika e Kosovës me mbështetjen e Terre des Hommes Misioni në Kosovë, Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve dhe Fondacionit HEKS, në kuadër të projektit - Drejtësia Sociale për romët,

ashkallitë dhe Egjiptianët financiar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Mbajtja e këtij samiti, ka shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024.

12. AKTIVITETET TJERA QË KANË SHËNUAR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI, 2022-2026 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024, TË CILAT JANË TË LIDHURA NË MËNYRË TË DREJTPËRDREJTË DHE JO TË DREJTPËRDREJTË ME FUSHAT DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Përveç aktiviteteve të elaboruara në pjesën e sipërme, sipas fushave të Strategjisë dhe Planit të veprimit, institucionet qendrore dhe lokale, kanë ndërmarrë edhe aktivitete të tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë afektojnë fushat e zbatimit dhe objektivat e strategjisë, për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024.

Kështu, ARC në bashkëpunim me akter të ndryshëm për të lehtësuar regjistrimin e gjendjes civile për personat në fjalë, gjatë vitit 2023 i ka ndërmarrë hapat si në vijim: Plotësim /ndryshimet në fushën legislative, në vitin 2023 është arritur të draftohet projektligjin për Gjendjen Civile. Tani projektligji për Gjendjen Civile është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe pritet të jetë në planin legjislativ në vitin 2024. Ndërsa sidat e theksuara nga DGJC dhe ARC lidhur me komunitetet rom dhe ashkali janë: lindjet në shtëpi; mos regjistrimi prindërve në regjistër të gjendjes civile; mos regjistrimi i prindërve ndër gjenerata; mungesa e komunikimit/bashkëpunimit të prindërve posaçërisht nënës, braktisja e prindërve veçanërisht nga nënat; lindjet jashtë Kosovës dhe mos evidentimi i tyre në gjendje civile nga shteti/vendi ku ka ndodhur lindja; kthimi përmes procesit të ripranimit për personat mbi moshën 18 vjeçare prindërit e të cilëve nuk janë të evidentuar në regjistër të gjendjes civile.

Akademia e Drejtësisë në Programin Trajnues për vitin 2023, në kuadër të trajnimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Tre (3) nga trajnimet kanë qenë me fokus në luftimin e diskriminimit dhe racizmit, që përfshin temat e trajtuara si në vijim: 1. KEDNJ-së si dhe korniza ligjore nacionale në rastet e diskriminimit dhe raporti me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore, 2. Aspekti material dhe procedural i Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij, 3. Krimet e urrejtjes. Përfitues në këto trajnime kanë qenë: gjyqtar, prokuror, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë.

Gjatë vitit 2023 IKAP ka organizuar kursin e trajnimit "Të drejtat e komuniteteve në Kosovë. Në këto aktivitete janë trajnuar 24 pjesëmarrës 10 nga niveli qendror dhe 14 nga niveli lokal, nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali. Janë organizuar 4 ditë trajnim.

MKRS ka ndarë grante dhe ka mbështetur OJQ që vijnë nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali. Bazuar në të dhënat përfundimtare sipas rezultateve finale të thirrjeve publike në 2023: Art dhe Kulturë (konkursi i parë); Art dhe Kulturë (konkursi i dytë); Mobiliteti kulturor; Botim libri-blerje-revista-autori; të shpallura nga DK/MKRS për vitin 2023, për përkrahjen financiare të projekt- propozimeve kulturore, gjithsejtë 18 (tetëmbëdhjetë) projekte janë përkrahur financiarisht nga fusha e artit dhe kulturës (trashëgimisë kulturore) për OJQ dhe Individ. Shuma për subvencionimin e projekteve për vitin 2023 (OJQ dhe Individ) është: 101,700.00 € (njëqind e një mijë e shtatëqind euro). Nga këto grante dhe financime të projekteve kanë përfituar tetëmbëdhjetë (18) organizata jo qeveritare, nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali.

Përgjatë vitit 2023, disa aktivitete që shënojnë zbatimin e strategjisë dhe shërbejnë për të dyshuar avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, ka ndërmarr edhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). Kështu në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit , në kuadër të Ditës së Forcës **“Open Day”** në mënyrë të organizuar kemi sjellë qindra vizitorë të Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në kazemat e Forcës së Sigurisë së Kosovës Prishtinë, Ferizaj Istog dhe Gjilan.

Po ashtu, pas situatës së vërshimeve në Janar 2023, ekipet e FSK së bashku me Ministrin kanë vizituar familjet e prekura nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian, dhe në të njëjtën kohë ata janë mbështetur me pako ushqimore, higjienike, dhe tenda strehuese.

Në kuadër të fushatës së vetëdijesimit të nxënësve mbi materiet e rrezikshme shpërthyes, ekipet profesionale të deminimit në FSK, kanë mbajtur ligjërata në shkollat që kanë numrin më të madh të nxënësve të komuniteteve në Ferizaj, Fushë Kosovë, Prizren, Mamushë dhe Dragash, pjesa dërmues e këtyre nxënësve kanë qenë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Po ashtu, gjatë vitit 2023 FSK rekrutuar 11 ushtarakë të rinj nga komunitetet prej tyre 4 ashkali, 1 rom, dhe 1 egjiptian. Komponentë kjo që dëshmon prezencën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet publike. Në linjë me këtë, me kërkesë të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës , Ministria e Mbrojtjes ka bërë evidentimin e 10 pozitive të lira të punës për zyrtar publik në Ministrinë e Mbrojtjes me qëllim të përmbushjes së 10% me komunitete jo shumicë sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (LZP).

Duhet theksuar se aktualisht komunitetet në FSK përfaqësohen me 182 ushtarakë apo shprehur në përqindje 4.3%. Prej të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve, 40 janë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, respektivisht 27 ashkali, 10 egjiptian, dhe 3 rom.

Rreth 500 të rinjë, kryesisht të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, kanë marrë pjesë, me rastin e shënimit të ditës së FSK. Ky Aktivitet është realizuar në mbështetje të Zyrës për çështje të Komuniteteve.

Gjatë vitit 2023, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në koordinim me Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka organizuar Ditën e Informimit për komunitetet "me rreth 100 pjesëmarrës dhe qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja dhe lehtësimi i politikave të rekrutimit të komuniteteve në Agjencitë e Sigurisë Publike siç janë Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Agjencia e Menaxhimi Emergjent, Dogana e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Bazuar në Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare- 2022-2026 në aktivitet e të cilës është caktuar përgjegjësia e AKSP, gjendja paraqitet e kënaqshme. Vetëm në trajnime specifike për vitin 2023 kanë përfituar gjithësejt 52 zyrtarë, në temat që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit.

Zyra për Çështje të Komuniteteve publikon buletin dy (2) javor, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ky buletin i dërgohet 900 organizatave dhe aktivistëve të komuniteteve, në gjuhën shqipe, serbe dhe rome.

Përmes fondeve nga qeveria për International Business College Mitrovica kanë përfituar shkollim tre (3) studentë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në komunën e Fushë Kosovës, në kuadër të 16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës në bazë gjinore janë organizuar dy takime me komunitetet : rom, ashkali, egjiptian një takim është mbajtur me gratë dhe një takim me të rinjtë dhe të rejtat, janë shpërnda materiale informuese: qanta, lapsa, maica, kalendar, fjonge, fletore me moton: SOT E ÇDO DITË, aktivitete janë realizuar në bashkëpunim me Mekanizmin Lokal Kundër Dhunës. Bazuar në Ligjin për mbrojtje nga Diskriminimi, nëni 25 komuna ka lansuar Platformën për të Drejtat e Njeriut në web faqen e komunës. Me qëllim të promovimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi kemi realizuar takime informuese me qytetarët kemi shpërnda ROLL UP 13 cop, në Lagjen 029 kemi organizuar dy takime informuese.

Një çështje e rëndësishme, në kuptim të Strategjisë dhe Planit të veprimit është edhe rintegrimi i komuniteteve rom dhe ashkali, të cilat janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

NDIHMJA DHE MBËSHËTETJA NË SKEMAT PËR RIINTEGRIM SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE (PËR KOMUNITETET ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIAN) PËR VITIN 2023

Sqarim: Një vendim i aprovuar nga organet vendimmarrës i një personi apo familje të ripranuar (riatdhesuar) mund të jetë përfutës i dy e më shumë skemave për Riintegrim.

Nr	Shërbimet e ofruara nga Buxheti i Riintegrit, Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare që mbështesin procesin e riintegrit		Përkatesia Etnike					
			Romë	Kosto mesatare e shpenzimeve	Ashkali	Kosto mesatare e shpenzimeve	Egjiptian	Kosto mesatare e shpenzimeve
1	Transport deri në komunën e origjinës	persona	9	489 €	25	1,359 €	/	/ €
2	Akomodimi i përkohshëm (7 ditor) në Qendrën e Akomodimit dhe ushqim i përgatitur (servuar)	persona	2	150 €	9	675 €	/	/ €
3	Pako ushqimore dhe higjienike dhe materiale (me një e më shumë furnizime)	persona	25	2,120 €	38	3,222 €	10	848 €
4	Akomodim me qera deri në 12 muaj (6 deri 12 muaj shfrytëzimi)	persona	52	45 188 €	60	52 140 €	20	17 380 €
5	Pakoja e ndihmës për dimër (dru për ngrohje)	familje	4	900 €	1	225 €	/	/ €
6	Vetëpunësim (financimi i biznesit)	persona	/	/	/	/	/	/
7	Trajnim në Punë	persona	/	/	/	/	/	/

Sqarim: Kemi të dhëna statistikore të pranuar nga institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare që janë pranuar pa specifika përcjellëse si përkatesia etnike, andaj numri i personave të riatdhesuar nga këto komunitete mund të jetë më i madh. Shërbimet e ofruara në tabelë janë të paraqitura si kosto mesatare e shpenzimeve për person, të riatdhesuarit i pranojnë këto shërbime me specifika të ndryshme, varësisht nga rasti.

13.PËRFUNDIME PËRKITAZI ME ZBATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT, NË DRITËN E PËRCAKTIMEVE TË DEKLARATËS SË POZNANIT

Përgjithësisht nga të dhënat e raportuara për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komunitetit rom dhe ashkali 2022-2026 dhe Planit të veprimit 2022-2024, vërehet se ka pasur një progres dhe kujdes lidhur me avancimin e të drejtave të këtyre komuniteteve në Kosovë, bazuar në përcaktimet e Deklaratës së Poznanit, me qëllim të integritit të romëve.

Nuk ka dilemë që përfundimet, në lidhje me përmbushjen e objektivave të Strategjisë dhe aktiviteteve të Planit të veprimit, duhet të shikohen, në kuptim të matjes së tyre, me përcaktimet e Deklaratës së Poznanit.

Në lidhje me rritjen e shkallës së punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali, në sektorin publik, si objektivë e Deklaratës së Poznanit, vlen të theksohet që viti 2023, ka pasur një zhvillim të rëndësishëm, për shkak të miratimit të Ligjit për Zyrtar Publik dhe Rregullores për punësimin e Zyrtarëve Publik, e cila përcakton kuotat e punësimit për komunitetet në Republikën e Kosovës dhe vendet e garantuara në sektorin publik.

Lidhur me banimin, bazuar në përcaktimet e Deklaratës së Poznanit, Qeveria e Kosovës, respektivisht MFPT, kanë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare, e cila pritet të ratifikohet në vitin 2024, e që ka për qëllim sigurimin edhe të banimit të komuniteteve rom dhe ashkali dhe në këtë kuptim kjo marrëveshje ndërkombëtare, e raportuar nga MMPHI, pritet të përmbushë në shkallë të theksuar përcaktimin e Deklaratës së Poznanit.

Lidhur me çështjen e arsimit, Institucionet e Kosovës, respektivisht MASHTI dhe institucionet lokale, kanë bërë përpjekje maksimale për integrimin e romëve dhe ashkallive, me qëllim të sigurimit të procesit mësimor, mësimin alternativ ose minimizimit të çregjistrimeve nga shkollat. Megjithatë, mbetet që edhe përgjatë viteve tjera të vazhdohet me punë intensive, në mënyrë që shkalla e braktisjes së shkollave të zvogëlohet dhe të rritet 90% shkalla e regjistrimit, në arsimin fillor dhe 50% në arsimin e mesëm.

Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera vartëse, kanë vazhduar që të mbështesin në mënyrë të theksuar zbatimin e strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, edhe në vitin 2023. Megjithatë mbetet që të punohet në drejtimin e hartimit të ligjeve të veçanta, me qëllim që të mbulimit të sigurimit shëndetësor.

Në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, janë bërë hapa të rëndësishëm në vitin 2023. Adresimi i rasteve nga Grupi Teknik dhe Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ka përmbushur në nivel të lartë mbrojtjen nga diskriminimi të këtyre komuniteteve, si përcaktim i Deklaratës së Poznanit. Në vitin 2023, për herë të parë, në kuadër të rasteve të raportuara në Grupin Teknik, me aktgjykim të gjykatës kompetente

është arritur mbrojtja nga diskriminimi e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Platforma Kombëtare, përgjatë vitit 2023, ka arritur të adresoj me sukses mbi dhjetë (10), raste që kanë pasur për objekt mos diskriminimin.